

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 17

(JANAR-QERSHOR 2025)

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1.Vendim nr. ____ datë 26.02.2025.....	4
2.Vendim nr. ____ datë 21.11.2024	10
3.Vendim nr.____, datë 27.12.2024	14
4.Vendim nr.____, datë 09.02.2024.....	19
5.Vendim nr.____, datë 09.07.2024.....	21
6.Vendim nr.____ datë 12.05.2025.....	22
7.Vendim nr.____, datë 21.03.2024.....	24
8.Vendim nr.____, datë 03.06.2025.....	26
9.Vendim nr.____, datë _____.....	28
10.Vendim nr.____, datë 30.01.2025.....	30
11.Vendim nr.____, datë _____	31
12.Vendim nr.____, datë _____	35
13.Vendim nr.____, datë _____	40
14.Vendim nr.____, datë _____	43
15.Vendim nr.____, datë _____	48
16.Vendim nr.____, datë _____	49
17.Vendim nr.____, datë _____	51
18.Vendim nr.____, datë _____	54

Në zbatim të nenit 28, të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj të internetit çdo gjatë muaj një buletin informues mbi vendimet e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese për çështjet tatimore, me qëllim informimin e tatimpaguesve dhe në bazë të të cilave, për raste të unifikuara, reflekton rast pas rasti vendimet teknike, të cilat zbatohen për raste të tjera të ngjashme.

Ky buletin përmban disa njohuri bazë mbi hapat që ndiqen nga tatimpaguesi gjatë procedurës së ankimit, si dhe përmbledhje të disa vendimeve të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, për çështjet tatimore. Ai është hartuar me një gjuhë të thjeshtë, por duke iu përmbajtur me saktësi terminologjisë ligjore të përdorur në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Informacion më të detajuar mund të gjeni në faqen tonë të internetit: <https://www.tatime.gov.al>

Qasja e lirë në legjislacionin tatimor dhe rregulloret e përditësuara, është e aksesueshme lehtësisht në linkun: <https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>

Shënim!

Informacioni i paraqitur në këtë material përshkruan situatën, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ky legjislacion mund të jetë objekt ndryshimi apo shfuqizimi. Informacioni ka vetëm qëllim informimi dhe nuk duhet të konsiderohet si këshillim apo opinion ligjor. Për zgjidhjen e një rasti specifik kërkoni ndihmë profesionale.

1. Vendim nr.____, datë 26.02.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria tregtare “V” sh.p.k.

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë
Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti: Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit nr.____, datë 23.08.2019.

Shuma e detyrimit tatimor: Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.____ datë 23.08.2019 dhe nr.____, datë 23.08.2018, për njoftimin e detyrimeve tatimore të raportit përfundimtar të kontrollit, në shumën totale _____ lekë.

Baza Ligjore: Nenet 31, 32 të K.Pr.Civile, Nenet 108, 109, 110, 111 e 128, 130 të Ligjit Nr.44/2015 “K.Pr.Administrative”, Nenet 68, 69, 81, 83, 84, 85 e vijues të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.24, datë 02.09.2008, Ligji Nr.7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH”, Ligji Nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, Udhëzimi Nr.17, datë 13.05.2008, Udhëzim Nr.6, datë 30.01.2015, Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligji Nr.9928, datë 30.01.2004 “Për kontabilitetin”, me ndryshimet përkatëse si dhe në përputhje me Udhëzimet e Ministrit të Financave në kuadrin e zbatimit të tyre, Shkresa orientuese e DPT Nr.____, datë 17.05.2006 në zbatim të VKM Nr.173, datë 29.03.2006 dhe Marrëveshjes së DPT dhe Shoqatës së Ndërtuesve, Nenet 32, 154-156 të Kodit të Procedurës Civile, Nenet 2 paragrafi 2, neni 7/a, neni 11 paragrafi 3, neni 14, 15, neni 16/b), neni 17/a, neni 18 dhe 21 të Ligjit Nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit: Gjatë vitit 2018–2019, paditësi ka qenë subjekt i kontrollit të thelluar nga organi tatimor, kontroll ky i njoftuar nëpërmjet Njoftim Kontrollit Tatimor nr.____ Prot., datë 04.09.2018, për të cilin paditësi ka marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar. Më vonë i është dërguar Program Kontrolli nr.____ Prot., datë 29.10.2018, në bazë të të cilit specifikoheshin llojet e tatimit dhe periudha përkatëse për të cilën do të ushtrohej kontroll.

Në vijim të procedurës paditësi ka marrë dijeni rregullisht për Projekt Raport Kontrollin Tatimor nr.____ Prot., datë 28.02.2019, nëpërmjet shërbimit postar sipas shënimit në librin e dorëzimit të shkresave në postë.

Në mbyllje të procedurës së kontrollit pasi janë marrë parasysh një pjesë e kundërshtimeve të paditësit duke e zvogëluar ndjeshëm detyrimin tatimor paraparak, në zbatim të nenit 84, pika 3, të ligjit nr.9920/2008, paditësit i është dërguar dhe ka marrë dijeni rregullisht për Raport Kontrollin Përfundimtar nr.____ Prot., datë 23.08.2019, nëpërmjet shërbimit postar sipas shënimit në librin e dorëzimit të shkresave në postë.

Duke qenë se ky subjekt është nën juridiksionin territorial të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, janë kryer veprimet për pasqyrimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.____ Prot., datë 23.08.2019, në sistemin informatik tatimor C@TS, duke ia njoftuar këtë akt bashkëngjitur Raport Kontrollit Përfundimtar nr.____ Prot., datë 23.08.2019, po nëpërmjet shërbimit postar.

Duke qenë se paditësi nuk ka qenë dakord me detyrimet që i kanë lindur ndaj organit tatimor, ka kundërshtuar Njoftim Vlerësimin për detyrimet nr.____ Prot., datë 23.08.2019, nëpërmjet ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë. Pasi shqyrtimit të ankimit, kjo drejtori me vendimin nr.____ Prot., datë 02.12.2019, ka vendosur:

Refuzimin e ankimit ndaj Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.____ Prot., datë 23.08.2019, nxjerrë nga DRT Gjirokastrë, për shkak se nuk është plotësuar kushti ligjor për pagesën apo vendosjen e garancisë bankare për detyrimin e përcaktuar në aktin administrativ të ankimuar.

Për kundërshtimin e këtij vendimi, paditësi i është drejtuar Gjykatës nëpërmjet kërkesëpadisë, me palët dhe objektin sikurse është cituar më sipër.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, gjykata e shkallës së parë, në kuptim të Nenit 17/2 të Ligjit Nr.49/2012, ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve të lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke mos identifikuar as dispozitat e detyrueshme për t'u zbatuar prej saj, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

Referuar shkakut dhe objektit të kërkesëpadisë, rezulton që paditësi “V” sh.p.k ta ketë orientuar shqyrtimin gjyqësor, në funksion të verifikimit të elementeve të pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimi Nr.____, datë 23.08.2019 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, në kuptim të Nenit 108 të K.Pr.Administrative, sipas përmbajtjes së të cilit:

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

- a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjisllacionit në fuqi lidhur me:*
- ii) procedurën e nxjerrjes së tij.*

Gjykata Administrative e Apelit çmon të nevojshme të evidentojë paraprakisht faktin se:

Së pari: Lloji i pavlefshmërisë që i atribuohet aktit objekt gjykimi, përbën elementin

përcaktues në funksion të analizës së pretendimeve të parashtruara në kërkesëpadi nga njëra anë dhe nga ana tjetër, të zbatimit nga gjykata të njërit prej parimeve themelore të procesit gjyqësor, parashikuar në Nenin 6 K.Pr.Civile, që parashikon se:

“Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”.

Së dyti: Në rast mosrënie dakord me vendimin e autoritetit tatimor, subjekti tregtar mund të mos e ezaurojë rrugën administrative të ankimit në Drejtorinë e Apelit Tatimor, duke e investuar gjykatën drejtpërdrejtë me padi, me objekt kërkimi, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimit tatimor.

Gjykatat në këtë rast e marrin çështjen në shqyrtim, në zbatim të Vendimit Unifikues Nr.3 Dt.12.02.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet të cilit rezultoi të jetë konkluduar ndër të tjera, se:

“28. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me juridiksionin dhe kompetencën, të cilat gjejnë rregullim në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe në ligje të Vera. Kuptimi, interpretimi dhe zbatimi i drejtë i këtyre dispozitave është detyrë e gjykatave.

29. Nuk është objekt i këtij gjykimi themeli i çështjes, por parë në këndvështrimin ligjor të mësipërm, kur për rastin konkret pretendohet se nxjerrja e njoftim vlerësimit tatimor, veprimet e administratës tatimore, përfshirë dhe ato të dy organeve të shqyrtimit të ankimit administrativ, janë në kundërshtim me ligjin, paditësi legjitimohet t’i drejtohet gjykatës. Legjitimimi (locus standi) i këtij subjekti konsiston në kuptimin që ai ka të drejtën për të vënë në lëvizje një proces gjyqësor kundër një akti administrativ.

36. Për këto arsye, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, me nenin 55 të ligjit për procedurat tatimore, ligjvënësi ka parashikuar organet kompetente, Drejtorinë e Apeliteve dhe Komisionin e Apeliteve, si shkallë hierarkike të apelit administrativ. Dhe, në përfundim të tij, në zbatim të garancive kushtetuese, nëpërmjet këtij ligji, tatimpaguesit i është njohur e drejta e ushtrimit edhe të “apelimit tatimor” sipas kërkesave të ligjit procedural civil (Neni 324 e vijues të K.Pr.Civile)...

38.3. Po kështu, nëse pretendohet pavlefshmëria absolute e akteve, kërkim që nuk është i ndërvaruar nga ndonjë afat parashkrimi, gjykatat nuk mund të nxierrë çështjen jashtë iuridiksionit gjyqësor, por në zbatim të nenit 121 të K.Pr.Administrative dhe 331 të K.Pr.Civile, konstaton pavlefshmërinë per efekt të zgjidhies së pasqive iuridike që janë krijuar nga akti”.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë, me të drejtë e ka pranuar për shqyrtim kërkesëpadinë e paditësit “V” sh.p.k, duke e konsideruar çështjen në juridiksion gjyqësor, me arsyetimin se:

“...kërkimi i paditësit ka të bëjë me kërkimin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi per Detyrimet nr.5239/4 prot, date 23.08.2019 të DRT Gjirokastër...

Kërkimet e konstatimit të pavlefshmërisë absolute mund të kërkohen dhe drejtpërdrejtë në gjykatë pa qenë e nevojshme ndjekja e ndonjë procedure të caktuar administrative.

Gjykata bazuar në dispozitën ligjore neni 18 i ligjit 49/2012, nëpërmjet të cilës janë

përcaktuar afatet e ngritjes së padisë, çmon se padia objekt shqyrtimi gjyqësor plotëson kushtin e respektimit të afatit për kundërshtimin e aktit administrativ në rrugë gjyqësore. Dispozita ligjore neni 18 të ligjit të mësipërm, përcakton afatin për ngritjen e padisë sipas të cilës: . 8. Padia për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë ". Për tu konstatuar një akt administrative absolutisht i pavlefshëm mjafton ekzistenca e njërit prej rasteve të përcaktuara në dispozitën ligjore neni 108 i K.Pr.Administrative... ”

Megjithatë, Gjykata Administrative e Apelit nuk konfirmon qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i takon zgjidhjes në themel të çështjes.

Në funksion të argumentimit të këtij përfundimi, Gjykata Administrative e Apelit vëren se, përkundër përfundimit të gjykatës së shkallës së parë që ka për ligjur pretendimet e palës paditëse për mosrespektim procedure në nxjerrjen e aktit administrativ objekt padie, me pasojë pavlefshmërinë absolute të tij, marrja në analizë e pretendimeve të kësaj natyre, dikton pashmangshmërisht referimin njëherësh edhe në dispozitat e Ligjit Nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, që parashikojnë përfundimin nga rregulli i përgjithshëm i disponimit, në rast shqyrtimi të padive me të njëjtin shkak dhe objekt, si në rastin konkret.

Konkretisht, në nenin 40/4 të ligjit, sa i takon llojit të vendimeve përfundimtare që mund të disponojnë gjykatat administrative, parashikohet në mënyrë eksplicite se:

“4. Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta ”.

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, pikërisht kjo dispozitë e parashikuar në ligjin e posaçëm, në bazë të të cilit funksionojnë gjykatat administrative, bëhet përcaktuese në raport me vlerësimin e pretendimeve për pavlefshmëri absolute, për shkak procedure, ngritur në padi.

Thënë ndryshe, Gjykata Administrative e Apelit vëren se, në funksion të zbatimit të kësaj dispozite, shqyrtimi i ligjshmërisë së akteve objekt gjykimi, dikton verifikimin e konfirmimit ose jo të të njëjtës situatë faktike, me gjithë respektimin ose jo të procedurës ligjore nga ana e organit publik.

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, prej paditësit nuk rezulton të jetë argumentuar pretendimi se, përlllogaritja e pasaktë e detyrimeve tatimore të evidentuara në njoftim vlerësimin objekt padie, do të ishte shmangur, nëse:

- *Njoftimi për kontrollin tatimor do të përmbante afatin e kryerjes së kontrollit;*
- *Njoftimi i programit të kontrollit do të ishte realizuar në një nga mënyrat e përcaktuara në ligj;*
- *Kontrolli do të ishte ushtruar në vend, sipas njoftimit për kontrollin tatimor.*
- *Kontrolli nuk do të zgjaste 4 muaj, por 15 ditë pune, sipas ligjit.*
- *Drejtori i Përgjithshëm do të kishte miratuar zgjatje të afatit;*
- *Raporti i kontrollit tatimor nuk do të ishte dorëzuar në datën 28.02.2019, pra rreth 9 muaj vonesë.*

- *Raporti i Kontrollit do të ishte miratuar nga strukturat përkatëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore.*

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, nëpërmjet pamundësisë për të justifikuar me shkelje procedurale, mosekzistencën e detyrimeve tatimore të papaguara, marrin përgjigje shteruese pretendimet e paditësit për pavlefshmëri absolute të Njoftim Vlerësimit Nr.____, datë 23.08.2019 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit nuk konfirmon përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, se:

“...nga pala e paditur janë shkelur hapur e në mënyrë flagrante dispozitat ligjore lidhur me procedurën e kryerjes së kontrollit mbi bazën e të cilit është nxjerrë njoftim vlerësimi Objekt shqyrtimi gjyqësor dhe konkretisht:

Pala e paditur nuk ka respektuar detyrimet e përcaktuara në nenin 81 të ligjit 9920/2006 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në lidhje me elementët e përmbajtjes së Njoftim kontrollit tatimor Nr. ____ Prot, datë 04.09.2018. Në këtë njoftim kontrolli nuk është përcaktuar koha e kryerjes së kontrollit si dhe afati i kryerjes, sipas pikës 2, germa "f", të nenit 81. Pala e paditur ka nxjerrë edhe shkresën Nr.____ Prot, datë 29.10.2018 "Program kontrolli ", në vijim të "Njoftim kontrollit me shkresën nr. _____, datë 04.09.2018 ". Në këtë program kontrolli midis të tjerash është parashikuar edhe afati i kryerjes së kontrollit i cili do të jetë 80 orë punë duke filluar nga data 29.10.2018 deri më datë 12.11.2018.

Në seancë gjyqësore nuk rezultoi e provuar se pala paditëse ka marrë njoftim për këtë program kontrolli.

Nëpërmjet shkresës Nr.____ Prot., datë 28.02.2019 pala e paditur i ka dërguar palës paditëse raportin paraprak të kontrollit njoftuar më datë 11.03.2019. Në seancë gjyqësore rezultoi se pala e paditur ka shkelur hapur dhe në mënyrë flagrante përcaktimet e nenit 83 pika I të ligjit 9920/2006, në nxjerrjen e raportit paraprak të kontrollit datë 25.02.2019.

Bazuar në shkresën Nr. _____ Prot., datë 29.10.2018 “Program kontrolli” pala e paditur kishte detyrimin që kontrollin e ushtruar ndaj palës paditëse t'a përfundonte brenda datës 12.11.2018. Pala e paditur ka përgatitur raportin paraprak të kontrollit më datë 25.02.2019, jashtë afatit.

Raporti paraprak i kontrollit i është njoftuar palës paditëse më datë 11.03.2019, nëpërmjet shkresës Nr. _____ Prot, datë 28.02.2018 dhe kjo e fundit është kundërshtuar nga paditësi më datë 13. 03.2019, depozituar në DRT Gjirokastrë më datë 15.03.2019 me shkresën nr. _____ Prot. Pala e paditur duhej që brenda afatit prej 14 ditëve nga marrja e kundërshtimeve ndaj raportit paraprak të kontrollit, të hartonte raportin përfundimtar të kontrollit. Pala e paditur ka hartuar Raportin Përfundimtar të Kontrollit më datë 10.05.2019 dhe pala paditëse ka marrë njoftim më datë 02.09.2019, bazuar ky fakt në lajmërimin e marrjes Nr._____. Për sa më sipër pala e paditur ka hartuar raportin përfundimtar të kontrollit jashtë afatit të përcaktuar në nenin 84, pika I.

Në seancë gjyqësore nuk u paraqit akti nëpërmjet të cilit Drejtori i Pergjithshëm i Tatimeve ka miratuar zgjatjen e afatit të kontrollit tatimor sipas përcaktimeve në germën "h ", paragrafi dytë i pikës 2 të nenit 81. Dhe sikur të jetë zgjatur ky afat prej 15 ditëve përsëri pala e paditur është në

shkelje flagrante të afatit të kontrollit tatimor pranë subjektit paditës.

Pala e paditur DRT Gjirokastrë në kundërshtim flagrant me pikën 3 të nenit 83 të ligjit mbi procedurat tatimore i ka dorëzuar subjektit paditës rezultatet e kontrollit të cilat nuk kanë qenë të miratuar nga struktura përkatëse e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë. Në seancë gjyqësore u provua se raporti i kontrollit është nënshkruar vetëm nga inspektori i kontrollit ai nuk është miratuar nga struktura përkatëse e Drejtorisë Rajonale Tatimore, përfshirë përgjegjësin e sektorit, drejtorin e kontrollit, si dhe Drejtorin e Drejtorisë Rajonale, dhe kopje e raportit të kontrollit të miratuar t'i jetë dërguar me postë subjektit paditës.

Akti administrativ objekt shqyrtimi gjyqësor është nxjerrë mbi bazën e një akti përfundimtar të kontrollit të pa miratuar nga urdhëruesi i kontrollit. Akti përfundimtar i kontrollit mban vetëm nënshkrimin e inspektorit që ka ushtruar kontroll”.

Nga ana tjetër, mosshterimi i rrugës administrative të ankimit në Drejtorinë e Apelit Tatimor, përbën pengesë për marrjen në shqyrtim të pretendimeve të bazuara në shkaqe pavlefshmërie relative të njoftim vlerësimit objekt padie, përse kohë bazohen në argumentin se:

- Është bërë rivlerësim tatimor në shkelje të neneve 71 dhe 72 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
- Nuk është aplikuar një metodë për vlerësimin e detyrimeve të të njëjtit ndërtim në kundërshtim me nenet 68, 36, 36/1, 36/2 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.
- Është ngarkuar me detyrim duke u trajtuar si dividend tërheqja e kontributit të ortakut, duke iu referuar vendimit të asamblesë së ortakut të vetëm...

Përfundimisht, në kuptim të Nenit 40/4 të Ligjit Nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Gjykata Administrative e Apelit nuk konfirmon përfundimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me ekzistencën e elementëve që provokojnë pavlefshmërinë absolute të Njoftim Vlerësimit Nr._____, datë 23.08.2019 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, ankimet e palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit, përmbajnë shkaqe për ndryshimin në favor të tyre, të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Vendimi i Gjykatës:

- *Ndryshimin e vendimit nr._____, datë 24.03.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.*
- *Rrëzimin e kërkesë padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

2. Vendim nr._____, datë 21.11.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria “V”sh.p.k. me NIPT _____

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Gjirokastër

Objekti: Shfuqizim i aktit administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.____ Prot., datë 13.12.2016.

Shfuqizim i aktit administrativ Vendim nr.____ prot., datë 21.07.2017, i Drejtorisë së Apelimit Tatimor

Shuma e detyrimit tatimor: Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.____ prot., datë 13.12.2016, për njoftimin e gjobës në shumën 500 000 lekë, për mosdeklarim të punonjësve.

Baza Ligjore: Kodi i Procedurave Civile neni 32/a, Ligji nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Ligji nr.8485 datë 12.05.1999, Kodi i Procedurave Administrative neni 116, Ligji nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 37, 68, 69, 70, 119/1/a, Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008.

Përmbledhje e rrethanave të faktit: Në datën 15.10.2016, sipas Urdhrit të Punës nr.____ Prot., datë 14.10.2016, në ambientin ku ushtron veprimtarinë paditësi, është ushtruar kontroll nga organi tatimor, gjatë të cilit ka qenë prezent si përfaqësuese e subjektit znj. N.K.

Gjatë kontrollit është mbajtur Akt–Konstatimi nr._____ datë 15.10.2016, i cili është lexuar dhe nënshkruar rregullisht pa asnjë kundërshtim nga kjo punonjëse, në cilësinë e përfaqësuesit të paditësit për momentin e kontrollit.

Në Akt–Konstatimin nr._____, datë 15.10.2016, referuar kontrollit dhe konstatimit në vend, midis të tjerash është evidentuar punonjësja N.K, e konstatuar në punë në momentin e kontrollit. Duke qenë se ky subjekt është nën juridiksionin territorial të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, u kryen verifikimet në sistemin informatik tatimor C@TS lidhur me deklarimin dhe përfshirjen në skemën e kontributeve, të punonjësve sipas Akt–Konstatimit nr.____ datë 15.10.2016, ku punonjësja N.K, ka rezultuar e padeklaruar në organin tatimor.

Në zbatim të nenit 68, të ligjit 9920/2008, Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, nxorri

aktin administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.____ Prot., datë 13.12.2016, duke i njoftuar paditësit penalizimin me gjobë.

Duke qenë se paditësi nuk ka qenë dakord me detyrimet që i kanë lindur ndaj organit tatimor, ai ka kundërshtuar Njoftim vlerësimin për detyrimet nr.____ Prot., datë 13.12.2016, nëpërmjet ankimit administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë. Pas shqyrtimit administrativ të ankimit, kjo drejtori me vendimin nr.____ Prot., datë 21.07.2017, ka vendosur :

Lënien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi, Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr.____ Prot., datë 13.12.2016, gjobë për punonjës të padeklaruar, periudha Nëntor 2016, në shumën 500.000 lekë, nxjerrë nga DRT Gjirokastrë.

Për kundërshtimin e këtij vendimi, paditësi i është drejtuar gjykatës nëpërmjet kërkesëpadisë, me palët dhe objektin e sipërcituar.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata Administrative e Apelit, referuar akteve provuese të administruara në dosjen gjyqësore, vlerëson se ka elementë të mjaftueshëm objektiv dhe subjektiv për të konkluduar se nga ana e tatimpaguesit shoqëria “V” sh.p.k është kryer shkelje në fushën tatimore, konkretisht ajo e mosdeklarimit të punonjësit, pasi provohet që ky subjekt të ketë mos ketë deklaruar rregullisht në organin tatimor të punësuarit e tij dhe nuk ka përmbushur rregullisht detyrimin për pagesën e sigurimeve shoqërore dhe kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Nga aktet në dosje provohet se shoqëria rezulton të ketë qenë objekt kontrolli nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Gjirokastrë në zbatim të urdhrit të punës nr. _____ Prot., datë 14.10.2016, ku është mbajtur akt konstatimi nr. _____, datë 15.10.2016, sipas të cilit ka rezultuar se: “...punonjësja N.K e konstatuar në punë në momentin e kontrollit...”.

Në vijim të konstatimit të kryer, DRT Gjirokastrë ka nxjerrë njoftimin e vlerësimit të detyrimit tatimor nr.____ Prot., datë 13.12.2016 sipas të cilit rezulton të jetë përcaktuar detyrimi tatimor në shumën 500.000 lekë, për shkak se subjekti nuk ka deklaruar në organet tatimore punonjësin N.K. Nxjerrja e detyrimeve është kryer sipas nenit 119/1 të ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pala paditëse e kundërshton shkeljen e konstatuar nëpërmjet kërkesëpadisë por fakti që akti i konstatimit është mbajtur në prezencë të punëdhënësit, i cili tek pjesa e nënshkrimit për tatimpaguesin nuk ka referuar asnjë pretendim lidhur me sa është evidentuar në akt konstatim, tregon se shkelja e përshkruar në këtë akt ka ndodhur realisht.

Pretendimi i palës paditëse se, punonjësja N.K, ndodhej rastësisht në ambientet e shoqërisë pasi ishte me leje lindje nuk ndryshon faktin e konstatuar që kjo punonjëse është gjetur duke punuar në shoqërinë “V” sh.p.k referuar akt konstatimit të mbajtur nga inspektorët e DRT Gjirokastrë më datë 15.10.2016. Në pikën 9 e vijues të udhëzimit nr. 23, datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, përcaktohet detyrimi ligjor për deklarimin dhe pagesën e kontributeve për personat të cilët janë ekonomikisht aktiv në dy ose më shumë subjekte.

Me padinë drejtuar gjykatës pala paditëse ka pretenduar se akti administrativ për dënimin e saj me gjobë në shumën 500.000 lekë i nxjerrë nga ana e DRT Gjirokastrë është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, kërkim i cili sipas nenit 18.8 të ligjit nr.49/2012 mund të kërkohej në çdo

kohë para Gjykatës.

Në çështjen në shqyrtim Gjykata Administrative e Apelit, si shqyrtoi aktet e dosjes gjyqësore vlerëson se akti administrativ i palës së paditur DRT Gjirokastër nuk është një akt absolutisht i pavlefshëm, referuar përcaktimeve të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit parashikohet se: *“Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik; ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ose iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit; b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”*.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, nga pala e paditur nuk konstatohet se ka shkelje të formës dhe procedurës të cilat të kenë ndikuar në nxjerrjen e akteve administrative. Është tashmë praktikë e konsoliduar gjyqësore që shkelja e formës dhe e procedurës mund të paraqitet në mënyra të ndryshme, por jo të gjitha shkeljet që lidhen me formën dhe procedurën mund të shpien detyrimisht në pavlefshmërinë e aktit. Mosrespektimi i këtyre elementëve duhet të jetë i atij karakteri dhe asaj rëndësie që të ketë ndikuar drejtpërdrejtë në nxjerrjen e aktit administrativ. Një shkelje e parëndësishme e procedurës apo formës së aktit nuk mund të shkaktojë pavlefshmëri absolute të aktit. Kjo edhe në harmoni me përcaktimet e nenit 40, pika 4 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, sipas të cilit është përcaktuar se : *“4. Gjykata vendos rrëzimin e padisë dhe kur vlerëson se, pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta”*.

Lidhur me rastin e parashikuar nga neni 108 gërma “a” gërma “ii” e Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit akti administrativ do të quhet absolutisht i pavlefshëm *“a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit nëfuqi lidhur me: ...ii) procedurën e nxjerrjes së tij;...”*, gjykata e shkallës së parë ka çmuar se duke qenë se akt konstatimi është mbajtur më datë 15.10.2016, rezulton e provuar se Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ Prot., datë 13.12.2016, është nxjerrë nga pala e paditur tej afatit 10 ditor të parashikuar nga neni 69 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky përfundim i gjykatës së shkallës së parë nuk konsideron faktin se në këtë rast akti administrativ është nxjerrë për dënimin me gjobë të palës paditëse për kryerjen e një kundërvajtje administrative dhe nuk përmban vlerësim tatimor, edhe pse sipas nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008 parashikohet vlerësimi i kontributeve nga organi tatimor me konstatimin e shkeljes.

Bazuar në ligjin organik nr. 9920, datë 19.05.2008, si dhe në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” (i ndryshuar), rezulton se për rastin në fjalë, pala e paditur arriti të provojë përpara gjykatës se tatimpaguesi shoqëria “V” sh.p.k nuk ka deklaruar në organet tatimore punonjësen N.K, duke kryer shkelje sipas nenit 119 të ligjit nr.9920/2008.

Sa më lart, Gjykata Administrative e Apelit çmon se akti administrativ, njoftim vlerësimi për

detyrime tatimore me nr.____ prot., datë 13.12.2016, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë në shumën 500.000 lekë, si dhe vendimi nr.____ prot., datë 21.07.2017, i Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, janë akte administrative të nxjerrë në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Në bazë të kësaj analize Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi gjyqësor nr.____, datë 09.10.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë që i ka shfuqizuar aktet administrative objekt padie është një vendim i pabazuar në rrethanat faktike të provuara gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në analizë të gabuar të kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit pala e paditur ushtron veprimtarinë e saj administrative, prandaj ky vendim duhet të ndryshohet dhe padia të rrëzohet. Për shkak të këtij disponimi dhe konform nenit 106 të K.Pr.Civile, shpenzimet gjyqësore të dokumentuara në gjykimin në shkallë të parë i lihen në ngarkim palës paditëse.

Në lidhje me të drejtën e kundërshtimit të këtij vendimi, Gjykata Administrative e Apelit vëren se neni 43 të Kushtetutës përmban normën kushtetuese se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështie civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.”* Sipas nenit 56 të ligjit të posaçëm nr. 49/2012 “Vendime të paankimueshme në Gjykatën e Lartë” normohet se: “Nuk lejohet rekurs ndaj vendimeve përfundimtare të Gjykatës Administrative të Apelit për padi me objekt: b) kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi...”.

Vendimi i gjykatës:

- *Ndryshimin e vendimit nr.____, datë 09.10.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe rrëzimin e padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*

Kundër këtij vendimi, nuk lejohet rekurs.

3. Vendim nr._____, datë 27.12.2024, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria “C”sh.p.k.

Të paditur: Drejtoria e Apelimit Tatimor
Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.

- Objekti:**
1. Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore nr.____Prot., datë 10.03.2017, të DRT Gjirokastrë, që përmban detyrimin për të paguar shumën në vlerën 500.000 (pesëqind mijë lekë të reja) nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë.
 2. Shfuqizimin e vendimit nr.____, datë 25.07.2017, i cili nuk na është komunikuar asnjëherë.
 3. Detyrimin për vënien në dispozicion të Vendimit nr.____ Prot., datë 25.07.2017.
 4. Detyrimin e palës së paditur për pagimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore, avokatore dhe ato përbarimore.

Shuma e detyrimit tatimor: Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.____ Prot., datë 10.03.2017, për njoftimin e gjobës në shumën 500 000 lekë, për mosdeklarim të punonjësve.

Baza Ligjore: Kushtetuta e Shqipërisë; Kodi i Procedurës Civile, nenet 31, 32/a, 43, 153, 154, 154/a, 156 të tij; Kodi i Procedurave Administrative, nenet 15, 16, 17, 21, 23, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 33, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41 të tij; Ligji 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Në zbatim të Urdhrit nr.____ Prot., datë 10.10.2015, është ushtruar kontroll nga organi tatimor dhe në përfundim është mbajtur Akt–Konstatimi nr._____, datë 29.10.2015. Duke qenë se ky subjekt është nën juridiksionin territorial të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, janë kryer veprimet për pasqyrimin e Njoftim vlerësimit për detyrimet nr._____, datë 10.03.2017, në sistemin informatik tatimor C@TS. Në lidhje me Akt–Konstatimin nr._____, datë 29.10.2015, në zbatim të nenit 68 të ligjit nr.9920/2008, inspektori ka mbajtur Akt–Vlerësimin datë 23.01.2016. Bazuar në vlerësimin e kryer Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, nxorri aktin administrativ Njoftim vlerësimi për detyrimet nr.____ Prot., datë 10.03.2017, duke i njoftuar paditësit penalizimin me gjobë në shumën

500 000 lekë për mosdeklarim punonjësi.

Duke qenë se paditësi, nuk ka qenë dakord me detyrimet që i kanë lindur ndaj organit tatimor, Avokate E.G në cilësinë e përfaqësueses ligjore të tatimpaguesit, sipas prokurës së posaçme me nr. ____ Rep. nr. ____ Kol. datë 13.04.2016, ka paraqitur ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor, Tiranë. Pasi u njoh me ankimin, nga ana e saj kjo drejtori me vendimin nr. ____ Prot., datë 25.07.2017, ka vendosur:

Refuzimin e ankimit me objekt: Ankim ndaj aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet Nr. ____ Prot., datë 10.03.2017, nxjerrë nga DRT Gjirokastër, pasi nuk janë plotësuar kërkesat sipas përcaktimeve të nenit 106 të Ligjit Nr.9920, i ndryshuar, ankimi nuk është paraqitur nga tatimpaguesi apo përfaqësuesi i tij.

Për kundërshtimin e këtij vendimi, paditësi i është drejtuar Gjykatës nëpërmjet kërkesëpadisë, me palët dhe objektin e sipërcituar.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, në aktin procedural që ka vënë në lëvizje Gjykatën Administrative, rezulton që në të, të kenë firmosur në cilësinë e përpiluesit si administratori i shoqërisë “C”shpk për llogari të kësaj të fundit, ashtu edhe avokate E.G. Në aspektin analizues të legjitimitimit procedural, shoqëria “C”shpk mban siglimin e padisë nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjor (administratori) duke mos vënë në diskutim këtë moment të parë të mbrojtjes së interesave të saj.

Në seancën e parë dhe të vetme në gjykimin administrativ në shkallë të parë të datës 29.1.2018, pala paditëse nuk paraqiti asnjë përfaqësues, ndërsa kërkoi shtyrje me shkrim për llogari të saj avokate E.G, duke pretenduar cilësinë e rregullt të përfaqësimit nëpërmjet prokurës së posaçme lëshuar nga administratori i shoqërisë me nr. ____ rep., dhe nr. ____ kol., hartuar në datë 13.4.2016, para notere R.M.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, e ka konsideruar prokurën e depozituar në dosjen gjyqësore si jo justifikues për raportin e përfaqësimit, duke e konsideruar ankimin administrativ përpara Drejtorisë së Apelimit Tatimor të ushtruar nga një person i paautorizuar, e duke legjitimuar kështu disponimin e kësaj Drejtorie dhe si pasojë, mospranimin e padisë për shkak të mosshërimit të ankimit administrativ, në kuptim të nenit 16 të ligjit nr.49/2012.

Ndryshe nga padia në gjykatën e shkallës së parë, ankimi i depozituar për llogari të shoqërisë “C”shpk mban vetëm firmën e avokates E.G, gjithnjë në referim të cilësisë së pretenduar të saj si përfaqësuese e shoqërisë, nëpërmjet të njëjtës prokurë të posaçme të sipërcituar.

Çështja që shtrohet për diskutim përpara Gjykatës Administrative të Apelit është, nëse av. E.G a mban cilësinë e përfaqësueses së shoqërisë në padinë konkrete, në bazë të prokurës së depozituar në gjykimin e shkallës së parë, dhe në pasojë, a justifikohet të nënshkruante në emër dhe për llogari të paditësit ankimin e veçantë?

Avokate E.G, e ka nënshkruar ankimin në emër të subjektit ankimues, bazuar në prokurën e

posaçme lëshuar prej tij me nr. ____ rep., dhe nr. ____ kol., hartuar në datë 13.4.2016, para notere R.M, ku lidhur me çështjen të cilës i referohet ky akt përfaqësimi, citohet si vijon:

“...i jap të drejta dhe kompetenca të plota të më përfaqësojë dhe në mungesën time, të cilës i jap të drejta dhe kompetenca të plota të më përfaqësojë mua dhe shoqërinë time në të cilën unë jam administrator, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me cilësinë e palës paditëse dhe me palë të paditur Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Avokatja ka të drejtë të më përfaqësojë mua të përfaqësuarën në të gjitha shkallët e gjyimit deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes që ka të bëjë me çështjen e referuar më sipër, si edhe në çdo çështje tjetër administrative, ku unë do të jem në cilësinë e paditësit dhe e paditur do të jetë Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe që ka lidhje me pretendimet e mia që rrjedhin nga padia e mësipërme...”

E njëjta prokurë është paraqitur përpara Drejtorisë së Apelit Tatimor në kuadër të paraqitjes së ankimit administrativ ndaj Njoftim Vlerësimit për Detyrimet, ankim i cili është firmosur nga Av. E.G dhe lidhur me të, DAT e ka konsideruar ankimin të refuzueshëm, pasi nuk është paraqitur nga tatimpaguesi dhe as përfaqësuesi i tij. Sipas DAT-së, avokatja nuk e mbart cilësinë si përfaqësuese e shoqërisë, pasi prokura e posaçme në fjalë e autorizon atë përpara organit gjyqësor dhe jo përpara DAT-së.

Në prokurën e paraqitur prej saj para palës së paditur DAT dhe Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjirokastër, është përshkruar e drejta e përfaqësimit e avokates në çështjen me palë të paditur Ministria e Financave, *Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por pa përcaktuar objektin e mosmarrëveshjes dhe as të paktën natyrën e konfliktit në emër të të cilit shoqëria vlerëson të paraqesë padi.*

Neni 96 i Kodit të Procedurës Civile, në gjermën “a” të tij e njeh avokatin si një ndër përfaqësuesit e palëve në gjykim, ndërsa përcakton në paragrafin e tij të dytë natyrën e prokurës, kur shprehet se: *“Prokura mund të jetë e përgjithshme ose e posaçme. Ajo bëhet me shkrim sipas dispozitave të Kodit Civil”.*

Neni 70 i Kodit Civil ka dhënë përkufizimin e prokurës nën parashikimin se: *“Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuari, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagrave që i ka dhënë përfaqësuesit”.*

Ndërsa neni 72 i këtij Kodi parashikon formën shkresore të prokurës dhe me akt noterial si rregull përpara organit gjyqësor, neni 71 i tij, ka përcaktuar se *prokura është e posaçme, kur i përfaqësuari i ka dhënë përfaqësuesit tagrin për të kryer një ose disa veprime juridike të caktuara, që karakterizohen nga një qëllim i përbashkët.*

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, ky lloj dokumenti ligjor, përdoret për të deleguar një autoritet të kufizuar dhe të mirëpërcaktuar, dhe përbën në thelb një autorizim nga lëshuesi për tu përfaqësuar në një çështje specifike, pa i dhënë përfaqësuesit mundësinë të veprojë në mënyrë të përgjithshme.

Referuar çështjes konkrete, specifikisht prokurës së lëshuar avokates së palës paditëse, konstatohet se:

- sa i përket formës, ajo është hartuar me akt noterial, ashtu sikurse e kërkon standardi që vendos neni 72 i Kodit Civil.

- sa i përket përmbajtjes, ajo është një prokurë e posaçme, ku vëllimi i tagrave të dhëna, lidhet me përfaqësimin në çështjen gjyqësore para Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë të paditur Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pa përcaktuar objektin e kërkesëpadisë, apo aktin administrativ/veprimin administrativ që do të kundërshtohet para gjykatës.

Në rastin konkret, referuar prokurës me të cilën është pajisur Av.E.G dhe ndryshe nga sa ajo pretendon në ankimin e nënshkruar prej saj, rezulton se:

- palë e paditur nuk është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, por janë autoritetet tatimore DRT Gjirokastrë dhe DAT;
- përfaqësimi në mosmarrëveshjen me objekt sipas kësaj kërkesë padie nuk rezulton të jetë përfshirë në prokurën e posaçme, pamundësi kjo që lind nga koha e lëshimit të prokurës në 13.4.2016, kur nuk kishte dalë asnjë nga aktet administrative të kundërshtuara gjyqësisht (*akti i DRT Gjirokastrë është i datës 10.3.2017, ndërsa vendimi i DAT 25.7.2017*);
- nuk përcaktohet as natyra e çështjes që përbën bazën e konfliktit, e cila minimalisht të orientonte tek organi publik i duhur (*organi tatimor*).

Pra, ushtrimi i së drejtës së ankimit nga Av.E.G në emër dhe për llogari të palës paditëse, duke nënshkruar ankimin objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor, rezulton të jetë ushtruar jashtë tagrave të përfaqësimit të saj, madje nuk rezulton që veprimet e paditëses pa tagra, të jenë miratuar më vonë me ndonjë akt tjetër përfaqësimi nga pala paditëse “C”shpk.

Gjykata Administrative e Apelit, i referohet në rastin konkret jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), e cila është *shprehur se rregullat që disiplinojnë hapat formalë për paraqitjen e një ankimi, synojnë të sigurojnë miradministrimin e drejtësisë*. Sipas saj, thelbi i së drejtës së aksesit në gjykatë çënohet kur rregullat procedurale pushojnë së shërbyeri qëllimeve të "sigurisë juridike" dhe "administrimit të duhur të drejtësisë" dhe formojnë një lloj pengese që pengon palën ndërgjyqëse që çështja e tij/saj të vendoset në themel nga gjykata kompetente (shih vendimin në çështjen Zubac kundër Kroacisë [GC], datë 05.04.2018, § 98). Në veçanti, çështjet e “sigurisë juridike” dhe “administrimit të duhur të drejtësisë” janë dy elemente kryesore për të bërë dallimin midis formalizmit të tepruar dhe zbatimit të pranueshëm të formaliteteve procedurale (*po aty*, § 98). Në shqyrtimin e proporcionalitetit të një kufizimi të aksesit në gjykatë, GJEDNJ merr parasysh gabimet procedurale të kryera gjatë procedurave, të cilat e penguan kërkuuesin të gëzonte një akses të tillë dhe përcakton nëse kërkuesi ishte detyruar të mbante një barrë të tepruar për shkak të këtyre gabimeve (*po aty*, §§ 90-95, 119).

Gjykata ka theksuar se të drejtat individuale, qoftë edhe të natyrës procedurale (këto të fundit të konceptuara në funksion dhe të garancive të të drejtave materiale), duhet të interpretohen gjithmonë në atë mënyrë që të jenë efektive (*shih vendimin nr.5, datë 2.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata Administrative e Apelit vëren se, prokura nuk është thjesht një dokument shkresor që pasqyron një raport përfaqësimi, por vullneti i një subjekti të përfaqësuar për të deleguar të drejtat e

tij tek përfaqësuesi në mbrojtjen e interesave të veta. Përfaqësuesi në gjykim, prezumohet se bën të pranishëm vetë të përfaqësuarin. Për këtë arsye, paraqet rëndësi të veçantë saktësia e disponimit të drejtave të deleguara me prokurë, të cilat, të japin në mënyrë të qartë dhe pa ekuivoqe kufijtë brenda të cilave shtrihet përfaqësimi. Në rastin konkret, avokatja nuk mund të pretendojë përfaqësim në një mosmarrëveshje me një organ publik, kur prokura i referohet haptazi një organi tjetër, qartësisht i ndryshëm nga i pari. Fakti që shoqëria paditëse nuk ka rikuperuar situatën nëpërmjet një akti vijues, e përforcon këtë qëndrim.

Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se mungesa e raportit të përfaqësimit ndaj shoqërisë “C” shpk nga avokatja për natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, nuk plotëson standardin e kërkuar nga neni 453 i Kodit të Procedurës Civile.

Mungesa e formës së aktit të ankimit analizohet në kohën e depozitimit të aktit, pra nuk mund të rikuperohet nëpërmjet plotësimit të elementeve të ankimit, në kuptim të nenit 455 të Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me nenin 46 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. Pika 2 e dispozitës së sipërcituar, i referohet situatës kur nënshkrimi mungon dhe jo kur përfaqësuesi nuk e mbart rregullisht këtë cilësi.

Sa më sipër, mungesa e elementit formal të nënshkrimit të ankimit nga një person–jo përfaqësues, e bën ankimin të papranueshëm përpara kësaj gjykatë.

Gjykata Administrative e Apelit, në përfundim të analizës së mësipërme, bazuar në nenin 50, gërma “a” të ligjit nr.49/2012, çmon se situata konkrete dhe bazueshmëria ligjore e saj, sipas dispozitave të sipërcituara, passjellin cilësimin të papranueshëm të ankimit të paraqitur ndaj vendimit nr.____, datë 29.1.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, i cili konsiderohet i nënshkruar nga avokatja jashtë tagrave të dhëna në aktin e përfaqësimit të lëshuar ndaj saj dhe të paraqitur në gjykatë.

Lidhur me të drejtën e rekursit: Vendimi i mospranimit të ankimit mund të kundërshtohet në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, mbi baza rekursi të veçantë. Kjo nisur nga parashikimi i nenit 450 të KPC, i cili është komplementues në parashikimet e tij ndaj ligjit nr.49/2012, neni I, pika 2 e tij, që thotë: *“Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për atë sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”*.

Ligji nr.49/2012 nuk trajton situatat e mospranimit të ankimit, ndërsa neni 450 i KPC, në pikën 2 të tij parashikon se: *“Kundër vendimit të mospranimit të ankimit mundet të bëhet ankimi i veçantë”* dhe në pikën 3 të tij se: *“Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi”*.

Në kuptim të nenit 450 të sipërcituar dhe nenit 443, paragrafi i fundit të Kodit të Procedurës Civile mbi afatin 5 ditor të ankimit të veçantë, rekursi - si mjet ankimi, ndjek fatin e këtij të fundit për në shkallë të dytë, ndaj konsiderohet me afat të veçantë.

Vendimi i Gjykatës:

- Mospranimin e ankimit të palës ankuese “C” shpk.
- Kundër këtij vendimi, lejohet rekursi i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 5 ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

4. Vendim nr. ____09.02.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

PADITËS : M.Z, Person Fizik

TË PADITUR : Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan
Drejtoria e Apelimit Tatimor

OBJEKTI: Shfuqizimin e Vendimit Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore Nr.____ prot datë 07.01.2020 dhe të Vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Nr. ____ prot datë 17.04.2020

Shuma e detyrimit tatimor: Njoftim Vlerësimi për Detyrimin Tatimor Nr.____ Prot., datë 07.01.2020, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, për detyrime në shumën totale ____ lekë.

Baza ligjore: Neni 31, 32 i K.Pr.Civile, Neni 116,117, 135,137 i Kodi i Pr. Administrative, Ligji Nr. 10279 “Për Kundravajtjet administrative”, Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Ndaj tatimpaguesit është ushtruar kontroll sipas Njoftim Kontrollit Tatimor nr.____ prot datë 05.11.2019 (referuar kërkesës për çregjistrim të tatimpaguesit datë 30.05.2019). Bazuar në rezultatet e kontrollit të kryer nga DRT Elbasan është konstatuar se tatimpaguesi ka shmangur detyrimin tatimor të TVSH-së nëpërmjet moslëshimit të faturave tatimore me TVSH, nga ana e tij për shërbimet e kryera janë lëshuar fatura të thjeshta tatimore dhe jo fatura me TVSH, duke mos llogaritur detyrimin tatimor për TVSH-në për 9 raste. Rezulton e provuar se me datë 01.03.2019 në mënyrë automatike nga sistemi tatimpaguesi është regjistruar me përgjegjësinë tatimore të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. Nga verifikimi i librave të blerjes të klientëve të tatimpaguesit për periudhën që ai kishte qenë me TVSH rezultoi se tatimpaguesi shitjet i kishte kryer me faturë të thjeshtë tatimore me nr.____, nr.____, nr.____, nr.____, nr.____, nr.____, nr.____ bllloqe të tërhequra pranë DRT Elbasan dhe jo me Fatura Tatimore me TVSH.

Në referim të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 68 pika 4 dhe pika 5, është bërë vlerësim tatimor nga ana e administratës tatimore ndaj tatimpaguesit M.Z pasi është konstatuar se tatimpaguesi është ngarkuar me përgjegjësi tatimore të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar prej datës 01.03.2019. Kjo përgjegjësi tatimore është shtuar automatikisht nga sistemi dhe subjekti ka marrë dijeni nëpërmjet njoftimit elektronik në faqen e tij të tatimeve e-filing. Nga të dhënat e siguruara nga sistemi informatik tatimor C@ts rubrika “Deklarata e Tatimpaguesit”, “Deklarata të Regjistruara” provohet se më datë 10.04.2019 tatimpaguesi ka bërë deklarimin e TVSH me afat dorëzimi tremujor, ku tatimpaguesi ka deklaruar TVSH me vlerë 0 (zero), më pas ka vijuar duke bërë deklarimin e TVSH-së më datë 11.07.2019. Në këto rrethana provohet se tatimpaguesi ka pasur dijeni për shtimin e përgjegjësisë tatimore të TVSH, në kushtet kur ai e ka deklaruar atë në muajin prill më datë 10.04.2019. Pretendimi i palës paditëse se është njoftuar me vonesë dhe se është furnizuar me fatura me vlerë TVSH-je me vonesë nuk është i bazuar në prova.

Për rastin në fjalë inspektori pas kontrollit të realizuar ka konstatuar dhe ka gjobitur tatimpaguesin sipas përcaktimeve të nenit 124 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Paditësi pranon rivlerësimin e bërë nga ana e organit tatimor por kërkon rishikimin e masës së gjobës për lëshim fature të pasaktë.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me lëshim fature tatimore të pasaktë por me moslëshim fature tatimore, ku sipas nenit 124 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008: *Moslëshimi i faturës tatimore, dëftesës tatimore apo i faturës tatimore me TVSH dënohet me gjobë të barabartë me 100 për qind të detyrimit tatimor, të padëklaruar ose të papaguar, si rezultat i moslëshimit të faturës, përveç tatimit dhe kamatvonesave që llogariten dhe paguhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji apo të ligjeve specifike tatimore.*

Neni 115 i Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar zbatohet vetëm në rastet kur tatimpaguesi ka plotësuar një deklaratë me të dhëna të pasakta, ndërkohë që ka zbatuar procedurat e tjera në lidhje me lëshimin e faturave tatimore me TVSH. Në kushtet kur paditësi nuk ka lëshuar faturë tatimore me TVSH ai ka kryer dy shkelje, moslëshim fature tatimore sipas parashikimeve ligjore të nenit 124 dhe plotësim deklarate tatimore të pasaktë sipas parashikimeve ligjore të nenit 115. Ndodhur në këto rrethana referuar parashikimeve ligjore të Udhezimit nr. 24/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, paragrafi 111.1.1 do të zbatohet vetëm një dënim, ai që është më i larti ndër to.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin e saj Nr.____ Datë 09.02.2024 vendosi rrëzimin e padisë. Gjykata ka vlerësuar ligjshmërinë e akteve administrative objekt gjykimi në kuadër të parimit të proporcionalitetit, në lidhje me nevojën e marrjes së një mase të tillë administrative. Për rastin në fjalë gjykata ka cmuar se jemi para një shkelje tatimore dhe ligji ka të përcaktuar saktë dënimin administrativ për shkeljen e kryer duke mos lënë opion tjetër në vendimarrje. Nga ana e palës paditëse nuk është lëshuar faturë tatimore në lidhje me shërbimin e ofruar ndërkohë që figuron i regjistruar si person fizik me TVSH, veprim ky që parashikohet si shkelje tatimore nga neni 124 i Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjykata konkludon se në çështjen objekt gjykimi nuk ka vend për paligjshmëri të vendimarrjes së palës së paditur, në kuptim të nenit 12 dhe 109 të Kodit të Procedurave Administrative.

Vendim:

- *Rrëzimin e padisë.*
- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

5. Vendim nr.____, datë 09.07.2024, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

PADITËS : I.P

I PADITUR : Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan
Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Ministrisë së Financave

OBJEKTI : Pavlefshmëri dhe kundërshtim i aktit administrativ: Njoftim Vlerësimi për detyrimet Nr.____ Prot., datë 24.01.2020 i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan; Vendimi Nr.____ Prot., datë 18.05.2020 i Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë

Shuma e detyrimit tatimor: Njoftim Vlerësimi për Detyrimin Tatimor Nr.____ Prot., datë 24.01.2020, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, për detyrime në shumën totale ____ lekë.

Baza ligjore: Neni 324, i Kodit të Procedurës Civile, Neni 116,117, 135,137 i Kodi i Procedurës Administrative, Ligji Nr.49/2012 Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative, Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Përmbledhje e rrethanave të faktit: Me anë të Njoftim Vlerësimi Nr.____ Prot., datë 24.01.2020, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, tatimpaguesi “I.P” është njoftuar për detyrime të papaguara, gjoba dhe kamatëvonesa për pagesë të vonuar të sigurimeve shoqërore në periudhat 2016/04 – 2019/11. Tatimpaguesi kundërshton vlefshmërinë e gjobave, duke pretenduar se ka qenë i detyruar për të zbatuar Vendimin Gjyqësor Nr.____, datë 21.12.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit, i cili urdhëron palën paditëse të paguaj pagën e punonjësit A.F gjatë kohës së qëndrimit në listë pritje. Pagesa e kësaj difference sipas vendimit gjyqësor është kryer me vonesë për arsye të akordimit të fondeve. Nga rideklarimi në sistemin informatik tatimor të pagesave kanë rezultuar gjoba për pagesë të vonuar si dhe kamatëvonesa. Për sa më sipër nga ana e palës paditëse është kërkuar pavlefshmëria dhe kundërshtimi i gjobave dhe kamatëvonesave sipas Njoftim Vlerësimi nr.____ Prot., datë 24.01.2020, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan.

Në lidhje me pretendimin e paditësit për paligjshmërinë e aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore Nr.____ Prot., datë 24.01.2020” nxjerrë nga DRT-Elbasan, si një zbatim i gabuar i Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke kundërshtuar vetëm detyrimet për kamatëvonesat dhe gjobat, shprehemi se:

Në Ligjin e posaçëm nr.9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 111 parashikon se : *Çdo veprim ose mosveprim i tatimpaguesit, agentit tatimor apo përfaqësuesit të tatimpaguesit, që bie në kundërshtim me ligjin dhe për të cilin ky ligj parashikon dënim administrativ, përbën shkelje tatimore administrative. Gjobat e vendosura për shkelje tatimore administrative mund të hiqen në rrethana të jashtëzakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi natyrore apo rrethana të tjera, të jashtëzakonshme, si vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore*

Gjithashtu Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 111.1, e në vijim parashikon se : *111.1 Çdo veprim ose mosveprim i tatimpaguesit, agentit tatimor apo përfaqësuesit të tatimpaguesit, që bie në kundërshtim me ligjin, dhe që nuk është vepër penale, përbën shkelje tatimore administrative dhe dënohet*

administrativisht. Për shkeljet që konstatohen, pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr.9920 datë 19.5.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", do të zbatohen nivelet e dënimeve administrative që parashikon ky ligj, pavarësisht nga koha kur ka ndodhur shkelja.....

Dispozita e ligjit të posacëm parashikon mundësinë e heqjes së gjobave të vendosura për shkelje tatimore administrative në rrethana të jashtëzakonshme, kur moszbatimi i legjislacionit tatimor është shkaktuar nga fatkeqësi natyrore apo rrethana të tjera, të jashtëzakonshme, si vdekja ose një sëmundje e rëndë e tatimpaguesit, ose kur tatimpaguesi vepron në përputhje me udhëzimet me shkrim të administratës tatimore, ndaj qëndrimi i paditësit për heqjen e dënimit administrativ nuk qëndron për sa kohë në ligjin e posacëm ky rast nuk gjen parashikim në ligj.

Detyrimet e llogaritura janë rezultat i një rideklarimi të bërë në zbatim të një Vendimi Gjyqësor dhe për sa kohë kjo situatë nuk është e rregulluar nga ligji, detyrime apo penalitete për situata që ligji nuk i rregullon shprehimisht në kohën e konstatimit të tyre mbesin në fuqi dhe administrata tatimore ka autoritetin dhe kompetencën për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

Ndërsa në lidhje me kundërshtimin e paditësit për heqjen e kamatvonesës shprehemi se, në referim të nenit 76 pika 4 të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Kamatëvonesa paguhet në çdo rrethanë dhe nuk mund të hiqet nga administrata tatimore, as të ankimohet, me përjashtim të rasteve kur ka gabime në llogaritje ose kur detyrimi tatimor, për të cilin zbatohet, ndryshon

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në vendimin e saj Nr.____, datë 09.07.2024 vendosi pranimin e padisë. Gjykata ka konstatuar ekzistencën e paligjshmërisë së aktit administrativ objekt gjykimi, duke vlerësuar për rastin në fjalë plotësimin e kushteve ligjore për shfuqizimin dhe fshirjen e detyrimeve të njoftuara përmes aktit administrativ përsa i përket kamatvonesave dhe gjobave duke lenë si të ligjshëm vetëm detyrimin bazë i lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe Tap, për të punësuarin gjyqfitues. Paditësi ka vepruar në përmbushjen e urdhërimeve të vendimit gjyqësor, pasi menjëherë pas ndërhyrjes për rivlerësimin e deklaratave tatimore që lidhen me pagimin e kontributeve nga punësimi, ka likujduar në mënyrë të plotë detyrimin e lindur nga vlerësimi. Pala paditëse ka ekzekutuar në mënyrë të plotë titullin ekzekutiv (vendim gjykate).

Vendim:

- Pranimin e padisë.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

6. Vendim Nr.____, datë 12.05.2025, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës: A.S, Person Fizik, NIPT K_____

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti: Shfuqizim i Vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Nr.____ Prot., datë 27.08.2010 dhe Rivendosje në afat të Ankimit ndaj Njoftim Vlerësimit Nr.____ Prot., datë 14.05.2010, të DRT Durrës.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore: Nenet 31, 32, 35, 36 e vijues të KPC, nenet 116, 117 të KPA, nenet 69, 71, 72, 80, 81, 83, 84, 106, 107, 109 e vijues të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Pala paditese ushtron veprimtarinë si “Person Fizik” me NIPT _____. Nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit në DRT Durrës, është ushtruar kontroll ndaj tatimpaguesit për Tatim Fitimin e viteve 2006, 2007, 2008, ku në përfundim të të cilit, nëpërmjet aktit administrativ Njoftim Vlerësimi dhe Raport Kontrolli Nr.____ Prot Dt. 14.05.2010, është njoftuar tatimpaguesi për detyrime tatimore me masën _____ lekë.

Tatimpaguesi pasi është njohur me Aktin Administrativ, e ka ankimuar atë në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, e cila nëpërmjet vendimit Nr.____ Prot Dt.27.08.2010, ka vendosur Refuzimin e Ankimit të palës paditëse, pasi ankimi administrativ është depozituar përtej afateve të percaktuara në Ligj.

Nga ana e Palës paditëse, është paraqitur Kërkesë përmes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, me objekt Shfuqizim të Vendimit të DAT Nr.____ Prot., Datë 27.08.2010 dhe Rivendosje në afat të Ankimit ndaj Njoftim Vlerësimit Nr.____ Prot., datë 14.05.2010, të DRT Durrës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, nëpërmjet Vendimit Nr.____, datë 07.04.2011, ka vendosur:

- Pranimin e Paditës së palës:

-Rivendosjen në afat të kërkesës për shqyrtimin e kërkesës ankimore pranë DAT, me argumentimin se pala paditese ka depozituar ankese pranë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT, por jo në DAT, për pasojë është detyrë e organit publik të dërgonte aktet në strukturën përkatëse përgjegjëse për shqyrtimin e çështjes dhe se afati ligjor, konsiderohet në këtë mënyrë i arritur nga ana e paditës.

-Nxjerrjen nga juridiksioni gjyqësor për pjesën tjetër të kërkesës.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar drejta e ankimit nga administrata tatimore.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit, gjatë shqyrtimit të çështjes, analizimit të akteve të paraqitura nga palët dhe argumentimit të pretendimeve të secilës prej tyre, ka konkluduar se Vendimi i dhënë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane, është i pabazuar dhe argumentuar në Ligj. Sipas Gjykatës, pavarësisht se pala paditese ka depozituar ankese pranë Drejtorisë së Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për aktin administrativ të leshuar nga DRT Durrës, për aq kohë sa ligji

material ka parashikuar se organi kompetent publik, per shqyrtimin e ankimit administrativ eshte DAT, detyrimi i pales paditese eshte qe te dergoje ankimin prane ketij te fundit. Per pasoje dhe perlllogaritja e afateve, eshte e lidhur ngushtesisht me depozitimin e ankimit administrativ ne organin publik kompetent, element ky qe perben nje parakusht dhe garanci proceduriale ne kuader te nje procesi te rregullt ligjor.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se Vendimi i Gjykates se shkalles se pare duhet te ndryshohet dhe kerkesepadia te rrezohet.

Vendim:

- *Ndryshimin e Vendimit Nr.____, datë 07.04.2011 të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.*
- *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*

7. Vendim nr.____, datë 21.03.2024 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës: Subjekti P.D, me NIPT _____,

Të Paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti : -Shfuqizimin e Njoftim-Vlerësimit për Detyrimet Tatimore Nr.____ Prot., datë 17.10.2016 i DRT Berat
-Shfuqizim i Vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Nr.____ Prot., datë 22.12.2016

Baza Ligjore : Ligji nr.49 datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, Ligji nr.10279, datë 20.02.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, ligji nr.8485, datë 12.05.1999 K.Pr.Administrative; ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Udhëzimi nr.24, date 02.09.2008; dhe vendimi teknik nr.22225 Prot., datë 16.07.2015 Për konstatimin dhe dokumentimin e shkeljeve administrative gjatë kontrolleve të ushtruara nga ana e strukturave të verifikimit në terren dhe hetimit tatimor (task-forcë)

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Subjekti P.D, me NIPT _____, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat “Mirëmbajtja e riparimi i mjeteve të transportit automobilistik”, me adresë të aktivitetit në Lagjen “Çlirim”, godinë njëkatëshe, pranë Urës së Re, Berat.

Me anë të Njoftim Vlerësimit Nr.____ Prot., datë 17.10.2016 dërguar nga DRT Berat, subjektit i është komunikuar penaliteti në vlerë _____ lekë për punonjës të padeklaruar, bazuar në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 119 pika 1 gërma b.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrativ për detyrimet tatimore Njoftim Vlerësimin Nr.____

Prot., datë 17.10.2016, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin Nr.____ Prot., datë 22.12.2016 ka vendosur:

-Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore nr. _____, datë 10.09.2015 të nxjerrë nga DRT Berat;

Ndodhur në të tilla rrethana, subjekti i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me objekt padie “Shfuqizimin e akteve administrative.....” në lidhje me njoftim vlerësimin Nr.____, datë 17.10.2016 të DRT Berat dhe Vendimin e Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë Nr.____, datë 22.12.2016.

Me vendimin nr.____, datë 27.03.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur:

- Rrëzimi i kërkesë padisë.

- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Kundër vendimit është paraqitur ankim nga pala paditëse në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila me vendimin Nr.____, datë 21.03.2024 ka vendosur:

- *Ndryshimin e vendimit nr.____, datë 27.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*
- *Pranimin pjesërisht të padisë.*
- *Shfuqizimin e pjesëshëm të Njoftim Vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____ prot., datë 17.10.2016 të DRT Berat dhe pjesërisht të vendimit nr.____ prot., datë 22.12.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë, sa i takon masës së gjobës nga 500,000 lekë në 50,000 lekë.*

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr.____, datë 27.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë duhet ndryshuar dhe padia të pranohet pjesërisht.

Gjykata Administrative e Apelit në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, në analizën e rrethanave të faktit, konkludon se gjykata e shkallës së parë nuk ka mbajtur parasysh se në datën 23.12.2015 Gjykata Kushtetuese kishte vendosur pezullimin e zbatimit të nenit 119 dhe në tërësi të ligjit nr.9920/2008. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.33/2016, e shpalli si të papajtueshëm me Kushtetutën. Baza ligjore mbi të cilën është ndëshkuar pala paditëse, neni 119, pika 1 e ligjit 9920/2008 që parashikonte masën e gjobës në vlerën 500.000 lekë ka qenë pezulluar në zbatim. Në këtë mënyrë gjykata e apelit vlerëson se aktet administrative janë akte administrative të cilat janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 119 të ligjit 9920/2008 i ndryshuar me ligjin nr.99/2015 i cili është i pezulluar në kohën e nxjerrjes së akteve për shkak se Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 23.12.2015 kishte vendosur pezullimin e zbatimit në tërësi të ligjit

nr.9920/2008 dhe si të tillë ato duhen shfuqizuar.

Në pjesën arsyetuese të vendimit Gjykata shprehet se: “ Gjykata Administrative e Apelit i referohet vendimit nr.18, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese, ku citohet se:...Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.33, datë 08.06.2016 përfundimisht vendosi: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 5,14,15,16 (pika 4 e shtuar në nenin 121), 17 pika 1 dhe 2, 18 (pika 2 e nenit 124) dhe 20 të ligjit nr.99/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”...

Bazuar në nenin 76 të ligjit 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” i ndryshuar, vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi prapavepruese, ndër të tjera ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykata, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë. E tillë është dhe çështja në gjykim...”

Sa më sipër sikundër është shprehur edhe në dispozitivin e vendimit të gjykatës, masa e gjobës prej 500,000 (pesëqindmijë) lekë do të bëhet 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë

8. Vendim nr._____, datë 03.06.2025 i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “P.Ç”, me NIPT _____;

Të Paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Berat
Drejtoria e Apelimit Tatimor

Objekti : Shfuqizimin e akteve administrative...

- Njoftim-Vlersimit për Detyrimet Tatimore Nr.____ Prot., datë 27.02.2017, i DRT Berat
- Vendimi i Drejtorise së Apelimit Tatimor Tiranë, nr._____, datë 19.07.2017

Baza Ligjore: Ligji nr.49/2012 “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarreshjeve administrative”, neni 3, pika 3, neni 7, neni 11, nenet 15 e ne vijim, neni 17, neni 34 i tij; Kodi i Procedurave Administrative, miratuar me ligjin nr.44/2015, neni 109, germa “d” dhe “e” e tij; Ligji nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vleren e Shtuar”; Udhëzimi nr.19 date 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit te vecantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi “P.Ç” me NIPT _____, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me aktivitet privat: “Prodhim përpunim të nënprodukteve bujqësore.Tregti të ambalazheve të llojeve të

ndryshëm.Mbarështim të bimëve mjekësore, etero-vajore dhe tanifere.Prodhim vere.Bar kafe, restorant. Vreshtari”, me adresë të aktivitetit në Urën Vajgurore, Berat.

Me anë të Njoftim Vlerësimit Nr.____Prot., datë 27.02.2017 për detyrimet tatimore i cili është rrjedhë e Raportit të Kontrollit të datës 27.02.2017 të kryer nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, subjektit i janë komunikuar detyrimet përkatëse.

Subjekti e ka ankimuar aktin administrativ për detyrimet tatimore Njoftim Vlerësimit Nr.____Prot., datë 27.02.2017, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr.____, datë 19.07.2017, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr. _____, datë 27.02.2017, nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat”.

Ndodhur në të tilla rrethana, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, me objekt padie “Shfuqizim të akteve administrative..”, e cila me vendimin Nr.____, datë 17.11.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur:

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në fakte, prova e në ligj.*

- *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse.*

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Kundër vendimit nr.____, datë 17.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka ushtruar ankim pala paditëse Person Fizik P.Ç, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr.____, datë 03.06.2025, ka vendosur:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.____, datë 17.11.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

- *Rrëzimin e kërkesëpadisë.*

Kundër vendimit, lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit çmon se, vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është marrë në zbatim të drejtë të dispozitave të ligjit material dhe referuar provave të shqyrtuara në gjykim dhe për rrjedhë ky vendim duhet lënë në fuqi.

Pretendimi në ankim i palës ankuese se, detyrimet dhe gjobat e TVSH-së, 2014 dhe 2015, janë aplikuar në kundërshtim jo vetëm me ligjin, por edhe me vetë konstatimet e inspektorese së kontrollit, janë pretendime të pabazuara në ligj dhe në provat e shqyrtuara në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë.

Referuar raportit të kontrollit përfundimtar të inspektorëve të palës së paditur, njoftuar paditësit me shkresën nr.____Prot., datë 27.02.2017 në faqen nr.14 të tij rezulton se, nga kontrolli i ushtruar mbi faturat tatimore të blerjeve rezulton se, pala paditëse ka filluar skemën e aplikimit të kompensimit të TVSH-së për blerjet e realizuara nga paditësi te fermerët S.N dhe A.I, përpara se këta fermerë të pajiseshin me NIPT-in e fermerit nga DRT Berat, pra në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.92/2014 “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë”, neni 147 pika ç, neni 150 si dhe udhëzimit nr.19, datë 03.11.2024 të Ministrisë të Financave, nenet 8 pika 4 dhe neni 9. Konkretisht fermeri S.N është i pajisur

me NIPT nga pala e paditur në datën 29.12.2014, ndërsa pala paditëse si datë fillimi të skemës së aplikimit të kompensimit të TVSH-së për blerjet e realizuara nga ky subjekt ka datën 07.12.2014, pra kompensimi i TVSH ka filluar nga pala paditëse për këtë fermer disa ditë para se ai të pajisej me NIPT nga pala e paditur DRT Berat, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të sipërcituara. Për këto transaksione me këtë fermer janë llogaritur detyrime përkatëse të TVSH-së në shumën _____ lekë.

Të njëjtën shkelje ligjore ka konstatuar inspektori i palës së paditur edhe për blerjet e paditësit nga fermeri A.I. Ky fermer është regjistruar me NIPT në datën 24.02.2015 ndërsa, pala paditëse deklaroi si datë fillimi të skemës së aplikimit të kompensimit të TVSH-së për blerjet e realizuara nga ky subjekt datë 04.12.2014, pra kompensimi nga pala paditëse për këtë fermer ka filluar disa muaj më parë se ai të pajisej me NIPT nga pala e paditur DRT Berat, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të sipërcituara. Për këto transaksione me këtë fermer janë llogaritur detyrimet përkatëse të TVSH-së në shumën _____ lekë.

E njëjta situatë paraqitet edhe me blerjet e kryera nga pala paditëse tek fermerët Xh.T dhe Z.T për të cilët nga pala e paditur janë llogaritur si TVSH të papaguara nga pala paditëse përkatësisht shumat _____ lekë dhe _____ lekë. Për mospagimin e TVSH-së, nga pala paditëse janë llogaritur edhe penalitetet përkatëse në masën ½ e detyrimit të TVSH-së të papaguara.

Pretendimi në ankim se nga ana e palës së paditur është interpretuar gabim ligji në nxjerrjen e këtyre detyrimeve, pasi faturat e blerjes kanë pasur të pasqyruar NIPT-in e fermerit është një pretendim i pabazuar. Pala e paditur ka zbatuar drejt nenin 147 të ligjit nr.92/2014 “Për TVSH-në në Republikën e Shqipërisë”, sikurse ka arsyetuar edhe gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj. Për periudhat kohore që fermerët ende nuk ishin të pajisur me NIPT nga pala e paditur, pala paditëse nuk mund të aplikonte skemën e kompensimit të TVSH-së.

Sa më sipër pretendimet e palës ankuese janë gjetur të pabazuara në prova dhe ligj nga ana e Gjykatës.

9. Vendim Nr.____ Datë _____, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës : Shoqëria “V”

I Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë

Objekt: Shfuqizim i pjesshëm i njoftim vlerësimit tatimor Nr.____, datë _____ i Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë.

Baza Ligjore : Kodi i Procedurave Administrative; Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar; Ligji nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr.8438/1998 ”Për Tatimin mbi të Ardhurat”; Ligji nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”

Përmbledhje e Fakteve:

Shoqëria ”V” është kontrolluar për periudhën 01/2014-03/2016 për tvsh-në dhe tatimet e tjera dhe për

periudhat 2013, 2014, 2015 për tatim fitimi. Në përfundim të kontrollit, tatimpaguesit i kanë lindur detyrime në shumën totale _____ lekë. Pala paditëse ka ankimuar pranë DAT vlerën _____ lekë dhe kjo e fundit me vendimin nr. _____ datë _____ ka vendosur shfuqizimin e pjesëshëm në shumën _____ lekë detyrime dhe _____ lekë ulje humbje dhe lënien në fuqi të detyrimeve të tjera të njoftim vlerësimit. Edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. _____ datë _____ ka vendosur të shfuqizojë detyrimet e pranuar nga DAT dhe rrëzimin për pjesën tjetër të kërtimeve. Kundër këtij vendimi pala paditëse ka bërë ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kjo e fundit me vendimin nr. _____, datë _____ ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë duke shfuqizuar të gjitha detyrimet objekt ankimi dhe konkretisht shumën _____ lekë detyrime dhe gjoba.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. _____, datë _____ ka vendosur shfuqizimin e pjesëshëm të njoftim vlerësimit dhe lënien në fuqi të detyrimeve të tjera objekt ankimi. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. _____ datë _____ ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë me nr. _____, datë _____ duke shfuqizuar dhe detyrimet e tjera të njoftim vlerësimit sipas kërtimeve në objektin e padisë. Në vendimin e saj gjykata ka konkluduar në mënyrë të përmbledhur se: Pala paditëse ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e borxhit dhe nuk është nevoja për ndonjë vendim falimenti nga gjykata ashtu siç pretendon pala e paditur. Bankës nuk mund ti kërkohet të zbatojë kriterin e shitjes nën kosto si një tregtar i zakonshëm mallrash dhe nuk mund të ngarkohet me detyrime shtesë në kushtet kur ka zbatuar legjislacionin tatimor në mënyrë të saktë, ka deklaruar dhe paguar tvsh-në mbi çmimin real të shitjes si dhe nuk ka konsumuar të drejtën e zbritjes së tvsh-së për këtë mall.

Llogaritja e tatimit në burim për sigurimet shoqërore dhe të tjera të personelit të huaj për vitet 2013, 2014 dhe 2015 është bërë në kundërshtim me ligjin nr.8438/1998, “Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pasi tatimpaguesi ka provuar se nuk kemi të bëjmë me pagesë për shërbim të ofruar nga një palë e tretë për subjektin pages. Banka nuk ka pasur detyrim ligjor për dorëzimin e njoftimit të transaksioneve të kontrolluara pasi nuk është përmbushur kriteri i shumës mbi 50 milion lekë për transaksione të kontrolluara.

Vendim: Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. _____ datë _____ ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë me nr. _____, datë _____ duke shfuqizuar dhe detyrimet e tjera të njoftim

vlerësimin sipas kërkimeve në objektin e padisë.

10. Vendim Nr. _____ datë 30.01.2025, Gjykata Administrative e Apelit

Paditës: Shoqëria “P.A.G” sh.p.k

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Apelit Tatimor

Objekti: Shfuqizimi pjesërisht i Njoftim Vlerësimin _____ Prot., datë _____ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, të Vendimit nr.____ prot datë _____ të Drejtorisë së Apelit Tatimor dhe deklarinin e shumë prej _____ lekë si shumë e TVSH-së së kreditueshme dhe të rimbursueshme.

Baza Ligjore : Nenet 17 e vijues të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar; Ligji Nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”; Ligji Nr. 92/2014 datë 02.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Përmbledhje e fakteve: Pala paditëse “P.A.G” sh.p.k është një shoqëri e cila ushtron aktivitet tregtar në fushën e montimit, riparimit, bashkimit të kabujve dhe paketave elektronike etj, tregtimit të mallrave apo shërbimeve dhe si subjekt tregtar fasonerie vetëm për tregun e huaj. Rezulton se veprimtaria “P.A.G” sh.p.k klasifikohet si aktivitet tregtar eksporti, me të drejtë kreditimi të TVSH-së në blerje. Në datë _____ shoqëria rezulton të ketë importuar makineri për prodhim kabujsh, në vlerë ta tatueshme _____ lekë dhe TVSH të llogaritur në vlerën _____ lekë.

Subjekti ka përfituar nga skema e shtyrjes së pagesës së TVSH për “Makineritë dhe pajisjet e importuara” në zbatim të VKM nr.559 datë 16.08.2006 “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë dhe pajisjet e importuara, si dhe energjinë elektrike të importuar nga KESH sh.a” i ndryshuar. Gjatë kontrollit dokumentar të deklaratës doganore dhe autorizimit për mallrat e importuar u konstatua se subjekti brenda afateve të përcaktuara në autorizim duhet të bënte pagesën e TVSH-së së shtyrë. Shuma e TVSH –së sipas shkallës tatimore që ka qënë në fuqi në çastin e importit të makinerive e pajisjeve është në shumën _____ lekë. Dega e Doganës Tiranë, rezulton të ketë disponuar vendimin nr.____ datë _____ ku ka vendosur që shoqëria të paguajë detyrimin doganor të papaguar në vlerën _____ lekë dhe dënimin e subjektit me gjobë në vlerën _____ lekë.

Tatimpaguesi “P.A.G” sh.p.k nëpërmjet kërkesës Nr.____ Prot., datë _____ rezulton të ketë bërë kërkesë pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për rimbursim teprice kreditore të TVSH-së për periudhën Shator 2014-Tetor 2016. Për këtë shkak, vetëdeklarimet dhe derdhjet e detyrimeve nga tatimpaguesi, rezultojnë të jenë bërë objekt kontrolli nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë.

Referuar nenit 76 pika 4 të ligjit nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, duke qënë se kanë kaluar 12 periudha nga momenti i lindjes së të drejtës së zbritjes së tvsh-së, shoqërisë i humbet e drejta e zbritjes së tvsh-së në shumën _____ lekë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka disponuar me Njoftim Vlerësimin Nr.____ Prot, datë

_____ që konsiston në ngarkimin e tatimpaguesit Shoqëria “P.A.G” sh.p.k, me detyrime (ulje gjendje kreditore) dhe gjoba në shumën _____ lekë.

Tatimpaguesi, duke mos qënë dakord me aktin administrativ ka kryer ankim administrativ pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, i cili ka lënë në fuqi Njoftim Vlerësimin Nr. _____ prot datë _____ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë. Duke mos qënë dakord me sa mësipër, tatimpaguesi e ka ankimuar çështjen në rrugë gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. _____ datë _____ ka vendosur: Rrëzimin e padisë. Pala paditëse ka ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se Gjykata e Shkallës së Parë ka cilësuar saktë faktet dhe veprimet e lidhura në këtë mosmarrëveshje duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për tu zbatuar në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes.

Me autorizimin nr. ___ datë _____ të lëshuar nga Dega e Doganës Tiranë, shoqërisë “P.A.G” sh.p.k i ka lindur e drejta e shtyrjes së afatit të pagesës së TVSH-së për pajisjen e blerë për një afat 6 mujor. Periudha 6 mujore ka përfunduar në datë _____, gjë e cila ka shtyrë efektet në kohë të llogaritjes së detyrimeve fiskale, lidhur me pagesën e TVSH-së për pajisjen e importuar pranë organit doganor i cili vepron si agjent tatimor për mbledhjen e detyrimeve tatimore për mallrat e importuar.

Gjykata vëren se, shoqëria në cilësinë e subjektit tatimpagues, me kalimin e afatit të dhënë për shtyrjen e pagesës së TVSH-së për pajisjen e importuar, kishte detyrimin për të deklaruar dhe paguar TVSH-në sikundër në kohën e importimit dhe zhdoganimit të tij. Pra, në datën _____ shoqëria nuk kishte më mbrojtje nga efektet e shtyrjes në kohë të pagesës sipas autorizimit nr. ___ datë _____ të Degës së Doganës Tiranë. Sikundër parashikon dhe VKM nr.559 pika 7 e saj, shoqëria paditëse e cila ka importuar makinerinë me qëllime investimi në veprimtarinë e saj ekonomike, kishte detyrimin që brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i kryerjes së importit të regjistronte në librin e blerjeve të TVSH-së, vlerën e kësaj makinerie dhe TVSH-në e zbatuar për importin e saj. Lidhur me kohën e kryerjes së pagesës së TVSH-së e cila kushtëzon regjistrimin e saj në librin e blerjeve, pika 5 e VKM –së ka përcaktuar se TVSH-ja e llogaritur nga organi doganor paguhet nga personi i tatueshëm importues, brenda dymbëdhjetë muajve nga çasti i importimit të makinerive dhe të pajisjeve.

Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur: Lënie në fuqi të Vendimit Nr. _____ datë _____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

11. Vendim Nr. _____ Datë _____, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “ L Auditing” sh.p.k me NUIS _____, me seli lagjia nr. _ Sarandë, me administrator _____ dhe _____

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

Objekti: 1. Shfuqizimin e vendimit nr. _____ prot datë _____ të Drejtorisë së Apelit

Tatimor, që ka refuzuar ankimin e paditësit.

2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë me nr. ____ prot datë ____ “Ndryshimi i përgjegjësisë tatimore” dhe aktit administrativ Memo nr. ____ prot datë ____ “Për ndryshim përgjegjësie” të sektorit të shërbimit të tatimpaguesve, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

Shuma e detyrimit tatimore: Shkresa nr. ____ prot., datë ____ e DRT Sarandë “Ndryshim përgjegjësish tatimore” shtim i përgjegjësisë tatimore te Tatim Fitimit.

Baza Ligjore : Neni 7/c, 17/c, 18/8, 21/2, 3 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Nenet 32/a, 119 e vijues të K.Pr.Civile; Nenet 108,109,110,132 e vijues të Kodit të Proçedurave Administrative; Ligji nr.9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008.

Përmbledhje e fakteve: Tatimpaguesi “ L Auditing” sh.p.k me NUIS _____, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesëpadinë me objekt: 1.Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë me nr. ____ prot datë ____ “Ndryshimi i përgjegjësisë tatimore” dhe aktit administrativ Memo nr. ____ prot datë ____ “Për ndryshim përgjegjësie” të sektorit të shërbimit të tatimpaguesve, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin. 2. Shfuqizimin e vendimit nr. ____ prot datë ____ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, që ka refuzuar ankimin e paditësit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë, me shkresën nr. ____ prot datë ____ ka njoftuar subjektin “ L Auditing” për shtimin e përgjegjësisë tatimore të Tatim Fitimit, me arsyetimin se për periudhën janar-gusht 2015 ka deklaruar të ardhura në vlerën ____ lekë, ndërsa për periudhën nëntor-dhjetor do të jetë ____ lekë, fitim i parashikuar. Kjo shkresë është dërguar në shërbimin postar më datë ____, brenda afatit të përcaktuar ligjor, duke bërë me dije tatimpaguesin “ L Auditing” sh.p.k që në vijim do të ketë këtë përgjegjësi tatimore, duke i kërkuar njëkohësisht që të marrë masa për deklarimin dhe pagesën në kohë të detyrimeve për këtë lloj përgjegjësie.

Nga ana e palës paditëse, ndaj shkresës nr. ____ prot datë ____ të DRT Sarandë “Për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore”, është ushtruar ankim në DAT Tiranë, e cila nëpërmjet vendimit nr. ____ datë ____ ka vendosur: *Mospranimin e rivendosjes ne afatin e humbur të ankimit të aktit administrativ, njoftim për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore nr. ____ prot datë ____; refuzimin e ankimit, me objekt aktin administrativ njoftim për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore nr. ____ prot datë ____ të nxjerrë nga DRT Sarandë, pasi nuk janë plotësuar kërkesat e përcaktuara në nenin 106 lidhur me paraqitjen në afat të ankimit”.*

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesëpadinë me objekt dhe bazë ligjore si kemi cituar më sipër. Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjyrokastër, me vendimin e saj nr. ____ datë ____ ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.

- Shfuqizimin e vendimit nr. ____ prot, datë ____ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ për ndryshim përgjegjësie tatimore të

Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, njoftuar paditësit nëpërmjet shkresës nr.____ prot, datë _____.

-Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.

-Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë duke kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative, me vendimin e saj nr _____, ka vlerësuar se:

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr.____, datë _____ ka zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur midis palëve ndërgjyqëse, por në kuptim të nenit 17/2 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, nuk rezulton të ketë cilësuar saktë faktet dhe veprimet e lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke mos identifikuar dispozitat e detyrueshme për t’u zbatuar prej saj në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes. Në lidhje me zgjidhjen në themel të mosmarrëveshjes, Gjykata Administrative e Apelit në analizë të kërkimeve në padi, provave të administruara në dosjen gjyqësore, pretendimeve të palëve, çmon se vendimi nr.____ datë _____ i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, për pranimin e padisë, është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe për këtë arsye ky vendim gjendet i cënueshëm.

Gjykata Administrative e Apelit në analizë të objektit të mosmarrëveshjes vëren të theksojë se, në bazë të nenit 107/4 të Ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, akti administrativ i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ezauruar ankimi në rrugë administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore. Në këtë rast sipas nenit 16 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, gjykata duhet të vendosë mospranimin e padisë, pasi ajo nuk i plotëson kushtet formale të paraqitjes në gjykatë. Sipas praktikës së Gjykatës së Lartë është konsoliduar qëndrimi se, nëse me anë të padisë kërkohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, nuk është e detyrueshme të ezaurohet më parë rruga administrative e ankimit. Në këtë rast, objekti i gjykimit konsiston në vërtetimin ose jo të njërit prej shkaqeve të parashikuara shprehimisht nga ligji për nulitetin e aktit administrativ. Në rastin në gjykim, nga aktet e gjykimit në shkallë të parë rezulton se paditësi tatimpagues i është drejtuar rrugës gjyqësore me objekt kërkimesh alternative në padi. Konstatohet nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi se, disponimi i gjykatës së shkallës së parë për pranimin e padisë është rrjedhojë e vlerësimeve të arritura nga kjo gjykatë mbi pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ shkresës nr.____ prot datë _____ të palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë. Pretendimet e palës paditëse se, ky akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm sipas nenit 116 të Kodit të Procedurës Administrative, janë pa mbështetje ligjore.

Ndryshimi i përgjegjësisë tatimore është kryer sipas procedurave që parashikon ligji nr.9920 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i është njoftuar palës paditëse përmes aktit shkresë nr. ____ prot datë _____ nga DRT Sarandë, organi kompetent i administratës tatimore, e cila mbikqyr e kontrollon veprimtarinë e palës paditëse tatimpaguese.

Referuar nenit 43 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: *2.Tatimpaguesi, statusi i të cilit ndryshon nga një kategori në tjetrën, sipas parashikimeve në ligjet e veçanta tatimore, duhet të njoftojë administratën tatimore, brenda 15 ditëve kalendarike nda data e regjistrimit të ndryshimit. Kur një ndryshim i tillë i statusit diktohet nga një kontroll i kryer nga administrata tatimore, qendrore ose vendore, administrata që kryen kontrollin njofton administratën tjetër, brenda 10 ditëve kalendarike pas kërrij ndryshimi.”*

Sa më lart, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë çmon se akti administrativ shkresa nr. ____ prot datë ____ “Ndryshim i përgjegjësisë tatimore”, të palës së paditur DRT Sarandë si dhe vendimi nr. ____ prot datë ____ i Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë, janë akte administrative të nxjerrë në përputhje me ligjin nr. 9920/2008 si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Përsa i takon pretendimeve për pavlefshmëri absolute që ngre pala paditëse dhe që ka konkluduar gjykata e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit çmon se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi nuk kanë lidhje me asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 116 të Kodit të Proçedurave Administrative, që të çojnë në pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ të kundërshtuar. Aktet administrative objekt shqyrtimi gjyqësor nuk paraqesin element të pavlefshmërisë absolute, pasi aktet janë marrë nga një organ administrativ i identifikuar dhe brenda kompetencës së tij të përcaktuar në dispozitat e ligjit nr. 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga pala e paditur nuk konstatohet të ketë shkelje të formës dhe proçedurës të cilat të kenë ndikuar në nxjerrjen e aktit. Në bazë të kësaj analize, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi gjyqësor nr. ____ datë ____ i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, që ka pranuar kërkimet objekt padie është një vendim i pabazuar në rrethanat e faktit të provuara gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në analizë të gabuar të kuadrit ligjor mbi bazën e të cilit pala e paditur ushtron veprimtarinë e saj administrative, prandaj ky vendim duhet të ndryshohet dhe padia të rrëzohet.

Për këto arsye Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. ____, datë _____ vendosi:

1. *Ndryshimin e vendimit nr.____, datë _____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe rrëzimin e padisë.*
2. *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse.*
3. *Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

12. Vendim Nr. ___ Datë _____, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: P.F P.B, me adresë Shkallë, Bashkia Konispol, i identifikuar me NUIS _____

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë

Objekti: Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr. ___ prot datë _____, për pagesën e TVSH-së në shumën _____ lekë.

Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. ___ prot datë _____ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimore: Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore ___ prot, datë _____ i Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë për detyrimin në zërin TVSH në shumën _____ lekë në total për periudhën 2014/05, 2014/06, 2014/09, 2015/10, 2014/10, 2014/11, 2014/07, 2014/12.

Baza Ligjore : Neni 109 i Ligjit nr.9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenet 32,152,154 të Kodit të Procedurës Civile; Udhëzimi nr.19 datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësor për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”; neni 9,10 i tij. Neni 108 i Kodit të Proçedurave Administrative.

Përmbledhje e fakteve: Tatimpaguesi P.B me Nipt _____, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesëpadinë me objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr. ___ prot datë _____ për pagesën e TVSH-së në shumën _____ lekë.

Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. ___ prot datë _____ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë me anë të shkresës “Autorizim për kryerje kontrolli” nr. ___ prot datë _____, ka njoftuar subjektin “P.B” në lidhje me kontrollin e plotë që do të ushtrohej tek ky subjekt duke vënë në dispozicion dhe Njoftimin e Kontrollit si dhe Programin e kontrollit me nr. ___ prot datë _____, në të cilin përcaktohet qartë ndër të tjera dhe periudha që do të kontrollohej subjekti e konkretisht: Për TVSH-në Dhjetor 2013-Mars 2016, Tatim Fitimi viti 2014-2015 dhe Kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore e TAP-in Dhjetor 2013-Mars 2016.

Gjatë kontrollit të kryer nga inspektorja e kontrollit janë nxjerrë shkeljet ligjore të kryera nga pala paditëse gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij ekonomik duke nxjerrë dhe detyrimet e penaltetet për çdo shkelje të kryer si dhe bazën ligjore për detyrimet e nxjerra. Më pas nga inspektorja e kontrollit të DRT Sarandë është mbajtur Raporti Paraprak i Kontrollit, i cili i është dërguar palës paditëse nga DRT Sarandë me shkresën nr. ___ prot datë _____. Në këtë Projekt Raport Kontrolli, inspektorja e kontrollit ka nxjerrë detyrimet dhe penalizimet për subjektin P.B si më poshtë:

Gjatë kontrollit të ushtruar u konstatua se subjekti P.B me Nipt _____ për blerjet e kryera për muajt Maj-Korrik 2014 nga fermer vendas, ka llogaritur kompensimin me 20%, veprim i cili vjen në kundërshtim me ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, neni 58.2 i tij. Neni 58.1 i Ligjit nr. 7928 datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, i ndryshuar citon qartë se: “1. Për fermerët, të cilët, në kuadër të veprimtarisë së tyre, në njërin nga fushat e prodhimit bujqësor e blegtoral, furnizojnë me këto produkte një person të tatueshëm, sipas kuptimit të këtij ligji, zbatohet skema e kompensimit të akorduar. Ministri i Financave, në bashkëpunim me ministrin përgjegjës për bujqësinë e blegtorinë, përcakton me udhëzim listën e produkteve të përfshira në këtë skemë. 2. Kompensimi i akorduar i paguhet shitësit fermer nga blerësi, person i tatueshëm, përkundrejt furnizimeve të kryera.” Ndërsa në nenin 58.2 të këtij ligji, citohet qartë se: Kompensimi është në masën 6 % ndërkohë që pala paditëse ka kryer kompensimin në masën 20%, duke vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, për blerjet e kryera nga fermerët për muajt Maj-Korrik 2014.

Nga ana e inspektorese së kontrollit është bërë sistemimi për muajin Maj 2014, ku subjekti ka deklaruar _____ kompensimin e TVSH-së në masën 20% dhe nga ana e inspektorit të kontrollit është korrigjuar duke e llogaritur me 6 % duke llogaritur ____ TVSH si normë kompensimi dhe duke nxjerrë diferencën si detyrim në shumën _____ lekë TVSH detyrim për ta paguar. Po ashtu për muajin Qershor 2014 nga ana e subjektit janë deklaruar nga pala paditëse blerje në shumën _____ lekë me TVSH 20% në shumën _____ lekë. Nga ana e inspektorese së kontrollit është korrigjuar duke u sistemuar kjo rubrikë dhe llogaritur TVSH-ja e kompensueshme me 6% si e përcakton dhe dispozita ligjore e konkretisht TVSH _____ lekë duke nxjerrë diferencën si detyrim për TVSH-në në shumën _____ lekë. Po ashtu, për muajin Korrik 2014 nga ana e subjektit janë deklaruar nga subjekti P.B blerje në shumën _____ lekë me TVSH 20% në shumën _____ lekë. Po ashtu, subjekti është penalizuar nga inspektori i kontrollit me gjobë në zërin e TVSH-së, bazuar në nenin 128 të Ligjit nr.9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pra, subjektit i është llogaritur nga inspektorja e kontrollit, për shkeljen e konstatuar dhe gjoba në zërin TVSH _____*50%=_____lekë gjobë. Gjatë kontrollit të ushtruar është konstatuar nga inspektorja e kontrollit se subjekti P.B për blerjet e kryera në muajt Shtator, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2014 nga fermer vendas dhe të deklaruara elektronikisht në sistemin tatimor nga vetë ky subjekt, kompensimi 20% i bërë nga subjekti është në kundërshtim me Ligjin nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”.

Për muajin Shtator 2014 pala paditëse ka deklaruar _____ lekë blerje nga furnitorë vendas me TVSH të kompensueshme 20% në shumën _____ lekë. Nga ana e inspektorese së kontrollit është sistemuar kjo situatë, ku këto blerje të kryera nga pala paditëse duke qenë se nuk janë kryer nga prodhues të cilët janë të pajisur me Nipt Fermeri nga DRT si dhe nuk ka lidhur akt-marrëveshje me fermerët

përpara aplikimit të skemës së kompensimit. Gjithashtu, nuk është njoftuar DRT Sarandë, ndaj kanë kaluar si blerje të përjashtuar në shumën _____ lekë duke i llogaritur një detyrim në TVSH në shumën _____ lekë. Për muajin Tetor 2014 pala paditëse ka deklaruar _____ lekë blerje nga furnitorë vendas me TVSh të kompensueshme 20% në shumën _____ lekë.

Nga ana e inspektores së kontrollit është sistemuar kjo situatë ku këto blerje të kryera nga pala paditëse, duke qenë se nuk janë kryer nga prodhues të cilët të ishin pajisur me Nipt Fermeri nga DRT si dhe nuk ka lidhur aktmarrëveshje me fermerët përpara aplikimit të skemës së kompensimit si dhe nuk ka njoftuar DRT Sarandë, kanë kaluar si blerje të përjashtuar në shumën _____ lekë duke i llogaritur një detyrim në TVSH në shumën _____ lekë. Për muajin Nëntor 2014 pala paditëse ka deklaruar _____ lekë blerje nga furniturë vendas me TVSh të kompensueshme 20% në shumën _____ lekë. Nga ana e inspektores së kontrollit është sistemuar kjo situatë ku këto blerje të kryera nga pala paditëse, duke qenë se nuk janë kryer nga prodhues të cilët të ishin pajisur me Nipt Fermeri nga DRT si dhe nuk ka lidhur aktmarrëveshje me fermerët përpara aplikimit të skemës së kompensimit si dhe nuk ka njoftuar DRT Sarandë, kanë kaluar si blerje të përjashtuara në shumën _____ lekë duke i llogaritur një detyrim në TVSH në shumën _____ lekë. Në lidhje me muajin dhjetor 2014, shprehet në këtë raport kontrolli nga inspektorja e kontrollit se, sistemimi është bërë nga Drejtoria e Vlerësimit, Përpunimit dhe Mbledhjes së të Ardhurave sipas aktit të rivlerësimit nr. _____ datë _____, por nuk është hedhur për arsye teknike.

Po ashtu në zbatim të nenit 128 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, subjekti është penalizuar nga inspektori i kontrollit për lëshim të faturës tatimore të pasaktë, me gjobë në zërin e TVSH-së në shumën _____ lekë = _____ lekë TVSH*50%, për periudhën Shtato, Tetor, Nëntor, Dhjetor 2014.

Inspektorja e kontrollit gjatë kontrollit të ushtruar ka konstatuar se subjekti P.B për blerjet e muajit Janar 2015-Tetor 2015 nga fermer vendas kompensimi në masën 20%, i bërë nga subjekti është në kundërshtim me UMF nr.19 datë 03.11.2014 “Për Zbatimin e Regjimit të Vecantë të Skemës së Kompensimit të Prodhuesve Bujqësorë Për Qëllime Të Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar”, neni 4 i tij. Nga ana e inspektores së kontrollit është llogaritur gjoba e tvsh-së në _____*50%=_____lekë gjobë, në zbatim të nenit 128 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.SH”, i ndryshuar, për lëshim të faturës tatimore të pasaktë.

Për sa më sipër, nga ana e inspektores së kontrollit është bërë rregullimi i tvsh-së _____*20%= _____ lekë, gjobë në shumën _____ lekë, totali në shumën _____ lekë. Ky raport kontrolli pasi është dërguar në shërbimin postar rekomandë nga DRT Sarandë me shkresën e saj nr. _____ prot datë _____, është pritur nga inspektorja e kontrollit bërja e kundërshtimeve të tatimpaguesit dhe të ndodhur para faktit ku ky subjekt nuk paraqiti kundërshtime në lidhje me këtë Raport Paraprak Kontrolli nga ana e DRT Sarandë me shkresën e saj nr. _____ prot u dërguar Raporti Përfundimtar i Kontrollit si dhe Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr. _____ datë _____. Raporti Përfundimtar i Kontrollit ka të njëjtat rezultate me Raportin Paraprak të Kontrollit, duke qenë se nga ana e subjektit P.B nuk kishte kundërshtime duke lënë të mirëqena të gjitha shkeljet e konstatuara në Raportin Paraprak të Kontrollit dhe të gjitha detyrimet dhe penalitetet e nxjerra në të. Subjekti P.B ndaj këtij akti administrativ

Njoftim Vlerësimi nr. ____prot datë _____ ka ushtruar ankim në rrugë administrative pranë DAT Tiranë, e cila me vendimin e saj nr.____ prot datë ____ka vendosur: *Refuzimin e ankimit ndaj Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore, nr.____prot datë ____, nxjerrë nga DRT Sarandë, për shkak se nuk është plotësuar kushti ligjor për pagesën apo vendosjen e garancisë bankare për detyrimin e plotë tatimor (kamatëvonesat) të përcaktuar në aktin administrative të ankimuar.*

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë me kërkesëpadinë me objekt: Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimi për detyrimet nr.____ prot datë _____, për pagesën e TVSH-së në shumën _____ lekë.

Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.____prot datë _____të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendimin e saj nr.____ datë _____ka vendosur:

- *Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot datë _____ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë, për pagesën e TVSH-së në shumën _____ lekë Tetor 2015 dhe gjobë në shumën _____lekë tvsh Dhjetor 2014.*
- *Shfuqizimin e aktit administrativ vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.*
- *Rrëzimin e kërkesë padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.*

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim DRT Sarandë, pala paditëse si dhe Avokatura e Shtetit, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative, me vendimin e saj nr.____datë _____ ka vlerësuar se:

Vlerësimi i Gjykatës:

Fillimisht kjo gjykatë vlerëson se pala paditëse krahas pretendimit për pavlefshmëri absolute në formë i shtrin pretendimet e tij dhe për pavlefshmëri relative të akteve objekt shqyrtimi. Në lidhje me këto kërkime, që lidhen me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësi nuk ka shteruar ankimin administrativ sipas ligjit nr. 9920/2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republinën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kjo referuar përcaktimeve të nenit 107 të këtij ligji dhe për pasojë nuk plotësohet një nga kushtet formale të padisë të përcaktuara nga neni 16.1 të ligjit nr. 49/2012 në të cilin përcaktohet se: “Padia ndaj veprimit administrativ ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ”. Nga aktet e marra në shqyrtim nuk rezulton që paditësi të ketë paguar detyrimin tatimor të caktuar në Njoftim Vlerësimin objekt shqyrtimi gjyqësor, e për pasojë DAT ka refuzuar marrjen në shqyrtim të ankimit administrativ. Në këto rrethana Gjykata Administrative e Apelit nuk merr në shqyrtim paligjshmërinë relative të akteve, shkaqet relative të

ngritura në padi me të cilat kundërshtohet akti administrativ objekt shqyrtimi, pasi për këtë çështje padia e paditësit nuk plotëson kushtet formale të saj.

Në lidhje me ankimin e paraqitur nga pala paditëse Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vlerëson se në ankimin e saj pala paditëse nuk bën referim në asnjë situatë konkrete të pavlefshmërisë absolute të aktit të kundërshtuar. Në rastin në fjalë, pala paditëse nuk ka paraqitur asnjë pretendim konkret mbi kompetencën e organit për të nxjerrë njoftim vlerësimin, mbi procedurën e nxjerrjes së tij dhe as për elementët e formës së aktit. Në këtë kuptim, brenda kufijve të shqyrtimit të ankimit të palës paditëse, kjo gjykatë e gjen të papranueshëm për shkaqet e pavlefshmërisë relative të pjesës së aktit që nuk është prekur nga gjykata administrative e shkallës së parë, dhe as nuk ka objekt analize ndonjë situatë të pavlefshmërisë absolute të referuar për trajtim nga pala paditëse. Nga të gjitha më sipër ankimi i palës paditëse nuk ka bazë juridike dhe asnjë argument i tij nuk qëndron.

Nga ana tjetër Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, ka konstatuar pavlefshmëri absolute të pjesës të njoftim vlerësimit nr. ____ prot datë ____ të DRT Sarandë, përsa i përket gjobës në shumën ____ lekë në zërin TVSH tetor 2015 dhe gjobë në shumën ____ lekë për TVSH dhjetor 2014. Për këtë pjesë të pranuar të padisë, kanë paraqitur ankim DRT Sarandë dhe Avokatura e Shtetit.

Gjykata Administrative e Apelit, për pjesën ku është pranuar kërkesëpadi, vëren se vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë ka tejkaluar vetë pritshmëritë e palës paditëse, sa kohë që mungesa e elementëve të nevojshëm në një akt administrativ, i shërben në thelb kuptueshmërisë së aktit dhe justifikimit në ligj të detyrimeve të vendosura mbi të. Sipas gjykatës së shkallës së parë, dy gjobat janë absolutisht të pavlefshme, për shkak se nuk janë të plotësuar rubrikat e detyrimit dhe kamatave që lidhen me to.

Ky parashimin, në asnjë rast nuk mund të interpretohet se, kur një rubrikë në aktin konkret të nxjerrë është e paplotësuar, detyrimi të cilit ajo rubrikë i përket, nuk ekziston. Një trajtim i tillë është empirik dhe i palogjikshëm. Sikundër rezultoi nga aktet e paraqitura në gjykim, ndër të cilat Raporti përfundimtar i kontrollit dhe procesverbalet bashkëlidhur atij, gjoba në shumën ____ lekë trajtohet në procesverbalin nr. _ datë _____, ndërsa gjoba në shumën _____ lekë për periudhën dhjetor 2014, trajtohet në procesverbalin nr. _ datë _____. Pra, pala paditëse sikundër dhe gjykata e shkallës së parë, janë njohur në raportin përfundimtar dhe me procesverbalet shoqëruese të tij, ndër të cilat ato me nr. _ dhe __, ku shpjegohet arsyeja e gjobës dhe detyrimet tatimore nga ato burojnë. Fakti që gjobat për detyrime tatimore të vendosura me një akt të mëparshëm, gjejnë pasqyrim në një akt të mëvonshëm të organit kompetent për aplikimin e tyre, nuk i bën ato gjoba absolutisht të pavlefshme. Nga sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se, akti administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot datë ____ është i vlefshëm dhe për pjesën që bën fjalë për gjobat e vendosura, respektivisht në shumën ____ lekë TVSH tetor 2015 dhe në shumën _____ lekë TVSH dhjetor 2014.

Lidhur me disponimin tjetër nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me të cilin ajo ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor, Gjykata Administrative e Apelit e gjen të mbështetur argumentimin e dhënë në ankimin e palës së paditur

DRT Sarandë, sipas të cilit, DAT nuk ka refuzuar shqyrtimin e ankimit për shkak se nuk janë parapaguar gjobat, sikundër arsyeton Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë. Padiësit i është refuzuar ankimi, pasi nuk është parapaguar një pjesë e detyrimeve që i përkasin këtij njoftim vlerësimi dhe që janë kamatat mbi vonesat e masës së detyrimit për TVSH-në e rivlerësuar. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se njoftim vlerësimi për detyrimet, konsiderohet si një akt i vetëm për efekte të ankimit të tij në rrugë administrative, lidhur kjo ngushtësisht me logjikën se detyrimet tatimore të nxjerra dhe penalitetet që i shoqërojnë ato, kur ankimohen në mënyrë tërësore, duhet të respektojnë kushtin e parapagimit me qëllim marrjen në shqyrtim të tyre në grup ankimi.

Nga sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit arrin në përfundimin se, vendimi nr. ____ datë ____ i Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, i cili ka disponuar për pranimin e pjeshëm të padisë, ka dalë në shkelje të dispozitave të ligjit material dhe procedurial për pjesën e pranuar të padisë dhe se duhet të ndryshohet, me pasojë rrëzimin tërësor të padisë.

Për këto arsye Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr. ____ - datë ____ vendosi:

1. *Ndryshimin e vendimit nr. ____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe rrëzimin e kërkesë padisë*
2. *Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse*
3. *Kundër vendimit lejohet e drejta e rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*

13. Vendim Nr. __ Datë _____, Gjykata Administrative e Apelit

Padites : Shoqëria “R” shpk

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
Avokatura e Shtetit

Objekti: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjeshëm (për kolonën 13) të “Njoftim Vlerësimit për Detyrimet” nr . ____ prot, datë _____.

Baza Ligjore : Nenet 32, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile; Ligji nr. 49/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Ligji nr. 33/2017 "Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes/shuarjes së detyrimeve tatimore"; Nenet 1, 2, dhe 5 të Ligjit nr. 9920, datë

19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përmbledhje e Fakteve:

Pala paditëse “R” sh.p.k., është e regjistruar me seli në Tiranë, në adresën: Rruga “Mihal Grameno”, me objekt veprimtarie në fushën e projektimit dhe zbatimit, në ndërtimet civile, industriale, turistike, bujqësore, kompletimi dhe instalimet e nevojshme për to, punime restaurimi. Gjithashtu, tregtim me pakicë dhe shumicë të të gjithë mallrave ushqimore, industriale, elektroshtëpiake, prodhime dhe tregtim të materialeve të ndërtimit, blerje dhe shitje të mjeteve të ndryshme, transport mallrash, grumbullim dhe shitje me shumicë dhe pakicë të produkteve bujqësore, blegtorale, bletore dhe eterovajore etj. Projektim dhe zbatim të ndërtimeve civile e industriale, turistike, bujqësore etj

Pala e paditur, DRT Tiranë me aktin administrativ Njoftim Kontrolli Tatimor nr. _____ prot., datë _____, në zbatim të programit të kontrollit të miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit, me objekt: “Kontroll i TVSH-së 10/2008 deri në 09/2010; Tatimit mbi Fitimin për periudhën 2008, 2009; Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore Tetor 2008 deri në Shtator 2010”, ka njoftuar palën paditëse “R” sh.p.k. për kryerjen e kontrollit nga inspektorët e ngarkuar për këtë qëllim. Me shkresën nr. _____ prot., datë _____ afatet e kontrollit janë shtyrë deri në datë _____ për shkak të mungesës së administratorit të paditësit (udhëtim jashtë vendit).

Në përfundim të kontrollit është hartuar Raport Kontrolli Tatimor datë _____, ku janë përshkruar shkeljet e konstatuara. Mbështetur në të dhënat e raportit të ushtruar pranë palës paditëse “R” sh.p.k ka dalë akti administrativ Njoftim Vlerësimi nr. _____ prot, datë _____, i palës së paditur DRT Tiranë. Pala paditëse “R” sh.p.k nuk ka paraqitur ankim administrativ ndaj rezultateve të kontrollit sipas aktit administrativ Njoftim Vlerësimit Tatimor Nr. _____ prot., datë _____, të palës së paditur DRT Tiranë.

Vlerësimi i Gjykatës: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. _____ datë _____ ka vendosur: Rrëzimin e kërkesëpadisë. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës paditëse. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi të arsyetuar.

Pala e paditur ka paraqitur ankim ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se shkaqet e ngritura në ankimin e palës paditëse “R” shpk nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj, për rrjedhojë vendimi nr. _____, datë _____, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duhet të mbetet në fuqi.

Pala paditëse “R” sh.p.k., nëpërmjet shkaqeve të ankimit në thelb parashtrohet se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë nuk ka bërë një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes, pa u ndalur në thelbin e kërkimeve dhe në faktet e paraqitura nga pala paditëse. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e palës paditëse dhe nuk ka dhënë një përgjigje të qartë e të argumentuar për pavlefshmërinë absolute të aktit administrative të kundërshtuar. Ky akt është nxjerrë jashtë objektit të autorizuar të kontrollit tatimor. Gjithashtu, akti administrativ është në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2017, i cili parashikon fshirjen dhe shuarjen e detyrimeve tatimore për periudhat përpara dhjetorit 2010. Pala paditëse pretendon se akti administrative është përgatitur në kundërshtim me procedurat ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 9920/2008. Gjithashtu, në kundërshtim me dispozitat ligjore, pala paditëse nuk është vënë në dijeni në mënyrë të rregullt për

konkluzionet e kontrollit tatimor dhe për vlerësimin e detyrimeve.

Gjykata Administrative e Apelit konstaton se, pala paditëse “R” sh.p.k., nëpërmjet shkaqeve të ankimit të sipërcituara, në thelb ka përsëritur po të njëjtat argumente mbi faktin dhe ligjin e zbatueshëm të parashtruara prej tij në kuadër të parashtrimeve të saj gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Paraqitja e një ankimi ku në vend që të paraqiten shkaqe konkrete se në cilat pjesë të arsyetimit dhe disponimit pretendohet se vendimi i kundërshtuar është i pabazuar në prova dhe/ose ligj, por thjesht ripërsëriten motivet mbi faktin dhe ligjin të ngritura në padi dhe në parashtrimet përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, përbën një ankim që është në kufijtë e pranueshmërisë për shqyrtim sepse praktikisht është një ankim që nuk përmban shkaqe konkrete ankimi sikurse kërkon ligji, por thjesht një kundërshtim gjenerik, pa shkaqe konkrete për arsyetimin dhe disponimin e gjykatës për zgjidhjen e çështjes.

Në mungesë të çështjeve mbi ligjin procedural të zbatueshëm dhe që ngrihen edhe kryesisht nga gjykata, si edhe në mungesë të shkaqeve thelbësore konkrete të ankimit të paraqitur nga pala paditëse shoqëria “R” shpk., pra të motiveve konkrete se në cilat pjesë të vendimit gjyqësor të ankimuar gjykata nuk ka zbatuar apo ka zbatuar gabim ligjin procedural ose material dhe se cilat prova apo fakte nuk ia ka nënshtruar debatit gjyqësor ose nuk i ka vlerësuar në vendim, në respektim të parimit themeltar të gjykimit se gjykata shprehet për gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet duke iu përmbajtur në vendimin e saj kufijve të shqyrtimit në apel (neni 465 pika 1 i K.Pr.Civile).

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se duhet të disponojë lënien në fuqi të vendimit të dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është i drejtë. Në nenin 68 të Ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, përcaktohet qartë dallimi midis kontrollit tatimor dhe vlerësimit tatimor. Kontrolli tatimor është një nga bazat mbi të cilat mund të kryhet vlerësimi tatimor, por ky i fundit mund të mbështetet gjithashtu në informacionin e deklaratave tatimore të vetë subjektit, siç ka ndodhur në rastin konkret në lidhje me vlerësimin e tatim-fitimit për periudhën objekt shqyrtimi.

Edhe pretendimi i palës paditëse se nuk ka pranuar dhe nënshkruar procesverbalet dhe Raportin e Kontrollit Tatimor sikurse e kërkon ligji, nuk përbëjnë shkak që sjell pavlefshmëri absolute të aktit. Vetëm një shkelje flagrante e procedurës në nxjerrjen e aktit mund të sjellë pasojë pavlefshmërinë absolute të aktit. Shkaqet e pavlefshmërisë absolute të aktit vlerësohen në raport me kuadrin ligjor në fuqi në momentin e nxjerrjes së këtij akti. Prandaj, në parim, parashikimet e një ligji të mëvonshëm nuk mund të vlerësohen nga gjykata si shkak për pavlefshmëri absolute të aktit të kundërshtuar.

Gjykata Administrative e Apelit vendosi:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr. ____, datë _____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

14. Vendim nr. ___ datë ___, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Subjekti tregtar A Gj, person fizik, i identifikuar me NIPT ___.

Të Paditur: 1- Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë 2- Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

Objekti:

- Shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ “Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore” nr. ___ prot., datë ___, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë.
- Shfuqizimi tërësisht i vendimit nr. ___ prot., datë ___ të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, Tiranë.

Baza Ligjore:

- Nenet 15, 16 dhe 17 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative”.
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 24/2008, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 31/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar.

Shuma e detyrimit tatimore: _____

Përmbledhja e fakteve:

Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren, pranë palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë në zbatim të urdhrit të punës nr. ___ prot., datë ___, kanë ushtruar kontroll pranë palës paditëse, subjektit tregtar A GJ, subjekt i përfaqësuar nga z. A GJ, me mjet identifikimi _____.

Sipas akt-konstatimit të datës ___, rezulton se në momentin e kontrollit në punë janë gjetur A Gj dhe 7 punonjës të tjerë.

Gjatë kontrollit u konstatua:

- a) Në vendin e biznesit me aktivitet “Hotel”, tatimpaguesi kishte instaluar pajisjen fiskale;
- b) Subjekti nuk kishte të afishuar listën e çmimeve në Bar–Restorant;
- c) Subjekti nuk lëshonte kupon tatimor – në momentin e kontrollit u gjet një tavolinë e shërbyer pa kupon tatimor.

Kontrolli u krye nga ora 12:30. U kontrollua nëse subjekti dispononte regjistër për regjistrimin në hotel dhe u konstatua se nuk kishte. Tek recepsioni u gjet në punë z. A Gj, me kartë identiteti _____. Tek recepsioni ishte afishuar lista e çmimeve në euro dhe u kontrollua nëse këto çmime ishin të regjistruara në pajisjen fiskale, por rezultoi se në pajisjen fiskale çmimet ishin në lekë.

Gjithashtu, u kontrollua nëse mbahej libri i xhiros për secilin aktivitet: bar–kafe, hotel dhe lokal dasmash, por nuk rezultoi të ekzistonte ndonjë libër për xhiron e realizuar. Në ambientin Bar–Restorant, në punë u gjetën kamarierët A Sh dhe E S, banakieri S K, dhe kuzhinierët S L dhe M G.

Drejtoria e Përpunimit, Vlerësimit dhe Kontabilitetit të të Ardhurave pranë palës së paditur, DRT Lezhë, bazuar në aktet e konstatimit të mësipërme, me aktin administrativ “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore” me nr. ___ prot., datë ___, ka bërë vlerësim tatimor për punëmarrës të padeklaruar, duke sanksionuar palën paditëse si më poshtë:

- Me gjobë për punëmarrës të padeklaruar në shumën ___ lekë;
- Me gjobë për mosmbajtje dokumentacioni në shumën ___ lekë;
- Me gjobë për moslëshim fature në shumën ___ lekë;
- Me gjobë në shumën ___ lekë, për shënimin e një vlere ndryshe nga ajo e afishuar;
- Me gjobë për mosafishim çmimesh në shumën ___ lekë.

Pala paditëse, subjekti tregtar A GJ, ka ushtruar të drejtën e ankimit administrativ kundër “Njoftimit të Vlerësimit për Detyrimet Tatimore” pranë palës së paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor (DAT). Kjo e fundit, pasi ka shqyrtuar ankimin, me vendimin nr. ___ prot., datë ___, ka vendosur:

- Ndryshimin e aktit administrativ, objekt ankimi, “Njoftim Vlerësimi për detyrimet Tatimore” nr. ___ prot., datë ___, të nxjerrë nga DRT Lezhë;
- Lënien në fuqi të këtij akti për:
 - Gjobën në shumën ___ lekë për punonjës të padeklaruar;
 - Gjobën në shumën ___ lekë për moslëshim kuponi tatimor;
 - Gjobën në shumën ___ lekë për lëshim kuponi me vlerë të ndryshme; dhe rrëzimin e ankimit për këto pika;
- Anulimin e aktit për gjobën në shumën ___ lekë për mosafishim çmimesh, dhe në lidhje me këtë pikë, i lihet detyrë DRT Tiranë zgjidhja e çështjes, sipas trajtimit në pjesën arsyetuese të vendimit.

Kundër këtij vendimi, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 109, lejohet ankim në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. ___ datë ___, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesëpadisë në këtë mënyrë:
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet me shkresën nr. ___ prot., datë ___, të drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, i cili është ndryshuar nga Drejtoria e Apelimit Tatimor, me shkresën nr. ___ prot., datë ___, që ka njoftuar detyrime tatimore për palën paditëse, subjektin person fizik A GJ.
- Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, që të heqë këtë detyrim tatimor nga dosja e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit, subjektit person fizik A GJ.
- Detyrimi për palën e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Afati për ekzekutimin e vendimit fillon kur vendimi të marrë formë të prerë dhe mënyra e ekzekutimit të vendimit të bëhet në mënyrë të detyrueshme si për kryerjen e një veprimi të caktuar.

- Shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifa për vënien në ekzekutim, që konsiderohen pjesë e shpenzimeve gjyqësore, t'i ngarkohen palës së paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë.
- Kundër këtij vendimi lejohet apel brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes. Për palën e aktorët në mungesë, afati fillon nga dita e njoftimit të vendimit.

Kjo gjykatë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se:

Administrata tatimore qendrore ka ushtruar kontroll mbi bazën e urdhrin të punës nr. ____, datë ____, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë. Më konkretisht, me shkresën nr. ____ prot., datë ____, është urdhëruar edhe se:

Objekt i kontrollit dhe verifikimit:

- a. Regjistrimi në organin tatimor
- b. Instalimi dhe përdorimi i pajisjes fiskale
- c. Deklarimi i të punësuarve
- d. Mosafishimi i çmimeve të shitjes dhe mosmbajtje në vende të dukshme të tabelës ku tregon detyrimin për marrjen e kuponit tatimor
- e. Verifikim për lëshim kuponi tatimor me të gjithë elementët e parashikuar në ligj

Urdhri i mësipërm i punës që ka ngarkuar për zbatim një inspektore të DRAKU-së Lezhë, është në kundërshtim të plotë me legjislacionin tatimor. Urdhri i mësipërm i punës që ka ngarkuar për zbatim vetëm një inspektore të DRT-së Lezhë, është gjithashtu po në kundërshtim të plotë me legjislacionin tatimor. Drejtori Rajonal disponon mbi administratën tatimore qendrore. Kontrolli dhe verifikimi në terren bëhet nëpërmjet strukturave të verifikimit në terren dhe hetimit tatimor (Task Forcë), nga më shumë se një punonjës në përbërje.

Edhe duke e përjashtuar këtë rrethanë fakti, gjë e cila gjithsesi nuk mund të konsiderohet kurrë ndryshe, administrata tatimore qendrore ka ushtruar kontroll duke tejkalluar objektin e kontrollit dhe verifikimit që ishte urdhëruar mbi bazën e urdhrin të punës, për llogari të mosmbajtjes së dokumentacionit, duke vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin tatimor.

Për shkeljet e gjetura nuk ka kryer procedurat ligjore, nuk ka mbajtur procesverbalët përkatës që sanksionojnë shkeljet, duke vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin tatimor, qoftë për mënyrën e mbajtjes së akt-konstatimit dhe qoftë për mosmbajtjen e procesverbaleve përkatëse që sanksionojnë shkeljet (neni 80 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar).

Administrata Tatimore qendrore ka ushtruar kontroll pa e identifikuar subjektin përkatës tatimpagues, nëse kemi të bëjmë me subjekt tatimpagues person fizik apo me subjekt tatimpagues person juridik, dhe procedurat e mëtejshme të kryera nga administrata tatimore qendrore e kanë trajtuar *a priori* subjektin tatimpagues si person juridik, në një kohë kur subjekti tatimpagues është person fizik, duke vepruar në kundërshtim të plotë me legjislacionin tatimor, qoftë për kontrollin, qoftë për mënyrën e mbajtjes së akt-konstatimit dhe qoftë për ndëshkimin e mëvonshëm që është bërë për subjektin përkatës tatimpagues.

Udhëzuesi nr. 22225, datë 16.7.2015 "Për konstatimin dhe dokumentimin ...", në zbatim të neneve 80 dhe 105 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, trajton pikërisht atë mënyrë të vepruarit të strukturave të verifikimit në terren dhe hetimit tatimor (Task Forcë), të cilën pala e paditur DRT Lezhë, nëpërmjet strukturave të verifikimit në terren, nuk e ka zbatuar.

Pala e paditur DRT Lezhë, mbi atë kontroll për shkeljet e gjetura, ka proceduar – vepruar pa urdhërimin përkatës të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (neni 80 i ligjit nr. 9920/2008).

Inspektorja e vlerësimit, mbi bazën e akt-konstatimit me nr. serial ____, datë ____, të strukturave të verifikimit në terren, në një kohë kur bëhet fjalë për pesë akte konstatimi të tilla dhe pa urdhërimin përkatës të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, në datën ____ ka mbajtur një akt vlerësimi të paprotokolluar, të panëshkruar nga askush për llogari të organit publik apo të administratës publike (vetëm sa ka një shkrim në fund: konceptoi emër mbiemër e specimen, që bëjnë fjalë për inspektorin e vlerësimit), dhe pa vulën e organit publik apo të administratës publike, duke trajtuar pesë shkeljet përkatëse të mësipërme dhe duke e dënuar subjektin përkatës *a priori* si person juridik (për më tepër akti – akti në fashikull). Aktet e mësipërme nuk i janë njoftuar subjektit përkatës.

Pala e paditur DRT Lezhë, me shkresën nr. ____ prot., datë ____, njoftim vlerësimi për detyrimet, për detyrimet tatimore për subjektin përkatës, ka vepruar mbi akt-konstatimet me nr. serial ____, datë ____; nr. serial ____, datë ____; nr. serial ____, datë ____; nr. serial ____, datë ____; dhe nr. serial ____, datë _____. Në këtë drejtim, njoftimi i vlerësimit për detyrimet tatimore është bërë jashtë afatit 10-ditor nga data e llogaritjes së vlerësimit (neni 69 i ligjit nr. 9920/2008).

Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se shkaqet e ngritura në ankimin e palës së paditur, DRT Lezhë, janë të mbështetura në prova dhe në ligj. Për rrjedhojë, vendimi nr. ____, datë ____, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër duhet të ndryshohet dhe të rrezohet kërkesa padi.

Pala e paditur, DRT Lezhë, nëpërmjet shkaqeve të ankimit të sipërcituara, në thelb parashtron se aktet administrative të kundërshtuara nga pala paditëse, subjekti tregtar A Gj, janë në përputhje me procedurën ligjore dhe të bazuara në shkeljet e konstatuara nga inspektorët e kontrollit gjatë kontrollit të kryer pranë këtij subjekti. Pretendimi i palës paditëse se inspektorët kanë vepruar jashtë objektit të kontrollit rezultojnë i pabazuar.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është provuar se DRT Lezhë ka respektuar të drejtat e tatimpaguesit (pala paditëse) dhe nuk është kryer asnjë veprim procedural që të sjellë pavlefshmëri absolute të këtij akti administrativ. Për këtë arsye, aktet administrative objekt i këtij gjykimi janë në përputhje me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, konkretisht neni 80 i ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar, i cili përcakton qartë objektin e kontrollit të administratës tatimore.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se njoftimi i vlerësimit për detyrime tatimore nr. ____ prot., datë ____, i DRT Lezhë, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, për shkak se është në shkelje të procedurës së parashikuar nga ligji nr. 9920/2008 dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Gjykata ka argumentuar se nuk janë mbajtur procesverbalet përkatëse që sanksionojnë shkeljet, duke u vepruar në kundërshtim me mënyrën e mbajtjes së akt-konstatimeve dhe procesverbaleve (neni 80 i ligjit).

Po ashtu, Gjykata e Shkallës së Parë ka arsyetuar se DRT Lezhë ka ushtruar kontroll pa e identifikuar në mënyrë të saktë subjektin tatimpagues si person fizik apo juridik, duke e trajtuar atë në mënyrë të gabuar si person juridik, ndonëse rezulton se subjekti është person fizik — gjë që përbën shkelje të legjislacionit tatimor.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, duke u nisur nga natyra e mosmarrëveshjes dhe rrethanat konkrete të faktit, gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar drejt mbi ligjin e zbatueshëm kur ka konkluduar se procedura administrative e ndjekur dhe akti administrativ ishin në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Kjo gjykatë vlerëson se përfundimet e gjykatës së shkallës së parë janë të gabuara dhe nuk qëndrojnë, pasi DRT Lezhë ka vepruar në përputhje me procedurat e ligjit nr. 9920/2008 dhe aktet nënligjore në fuqi.

Arsyetimi në vendimin e shkallës së parë nuk gjen mbështetje as në ligj dhe as në prova. Gjendja faktike nuk është trajtuar në mënyrë të plotë dhe të saktë.

Pretendimi se akti është nxjerrë në kundërshtim flagrant me ligjin është i pabazuar, pasi ai është marrë nga një organ kompetent dhe brenda formës së kërkuar nga ligji. Shkeljet e pretenduara nuk janë të natyrës që të sjellin pavlefshmëri absolute.

Aty ku janë ndjekur parimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjit nr. 9920/2008, si dhe aktet nënligjore përkatëse, nuk qëndron pretendimi për pavlefshmëri. Subjekti paditës është njoftuar për zhvillimin e kontrollit tatimor dhe është njohur me rezultatet dhe përmbajtjen e akt-konstatimeve.

Gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit për daljen jashtë objektit të kontrollit është i pabazuar. Neni 68 i Ligjit nr. 9920/2008 bën qartësimin ndërmjet kontrollit tatimor dhe vlerësimit tatimor, duke e lejuar këtë të fundit të mbështetet mbi rezultatet e kontrollit.

Në këtë rast, Njoftimi për Vlerësim të Detyrimeve Tatimore nr. ___ prot., datë ___, është një akt administrativ i nxjerrë në përputhje me procedurën përkatëse ligjore. Shkeljet e pretenduara nuk janë të natyrës thelbësore dhe nuk kanë ndikuar në përfundimin e çështjes sipas kuptimit të nenit 40 pika 4 e Ligjit nr. 49/2012.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ankimi i palës së paditur, DRT Lezhë, është i mbështetur në ligj dhe në prova. Si rrjedhojë, vendimi nr. ___, datë ___, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, duhet të ndryshohet dhe padia të rrëzohet.

Duke u nisur nga vlera e mosmarrëveshjes, e cila është ___ lekë, dhe bazuar në shkronjën “b)” të nenit 56 të Ligjit nr. 49/2012, Gjykata vlerëson se nuk lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Vendimi:

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të shkronjës “c)” të nenit 50 dhe shkronjës “b)” të nenit 56 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr. ____ datë ____, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe rrëzimin e kërkesë-padisë.
2. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

15. Vendim nr. ____ datë ____, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës : Shoqëria J K shpk

I paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore, Korçë

Objekti: Shfuqizimi i aktit Njoftim Vlerësimit Tatimor dërguar me shkresën nr. ____ prot datë ____ për të paguar gjobën në shumën ____ lekë, lënë në fuqi me vendimin nr. ____ prot datë të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: Në total detyrime për TVSH në vlerën prej ____ lekë.

Baza Ligjore :

1. Nenet 31,32,154 Kodi Procedurës Civile;
2. Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
3. Ligji nr.49/2012 Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative;
4. Ligji nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”.

Përmbledhje e Fakteve:

Nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Sektori i Kontrollit nga Zyra në datën ____ është mbajtur një proces verbal në lidhje me verifikimin e librave të shitjes, konkretisht deklarimin e shitjeve të kryera nga ana e subjektit. Subjekti ka kryer shitje me pakicë në individë konsumatore të cilat i ka regjistruar në librat e shitjes ndërkohë që subjekti rezultoi i regjistruar si subjekt shumice me një adresë kryesore. Mbi llogaritjet e bëra në këtë proces-verbal është nxjerrë akti administrativ njoftim vlerësimi tatimor nr. ____ prot., datë ____ me gjobë për tvsh në vlerën prej ____ lekë.

Tatimpaguesi ka kundërshtuar Njoftim Vlerësimin Tatimor në Drejtorinë e Apelit Tatimor e cila me vendimin nr. ____ prot datë ____ ka vendosur lënien në fuqi të gjobës.

Paditësi i është drejtuar gjykatës dhe kërkon shfuqizimin e njoftim vlerësimi tatimor për detyrimet e nxjerra nga DRT Korçë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë me vendimin nr. ____ datë ____ ka vlerësuar se paditësi ka kryer shitje me shumicë nëpërmjet faturave tatimore dhe shitje me pakicë nëpërmjet pajisjes fiskale në të njëjtin ambjent, vërtetuar kjo me adresën e cila është regjistruar e njëjtë si në faturën tatimore ashtu edhe në pajisjen fiskale. Ky fakt provohet edhe me adresën që shoqëria ka

deklaruar në regjistrin tregtar. Në këto kushte pala e paditur me të drejtë e ka cilësuar zhvillimin e aktivitetit tregëtar në kundërshtim të parshikimeve ligjore e cila dikton në mënyrë të pashmangshme rivlerësimin tatimor sipas mënyrës alternative të vlerësimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi rrëzimin e kërkesë padisë.

Gjykata Administrative e Apelit arsyeton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejt rrethanat e faktit. Gjykata ka argumentuar se nuk konstatohet asnjë parregullsi procedurale në masën që të ketë prodhuar një akt administrativ të pavlefshëm në kohën e verifikimit të librave të shitjes. Ka rezultuar e provuar së gjatë kontrollit të dokumentacionit të dorëzuar nga pala paditëse është konstatuar se pala paditëse ka kryer shitje me pakicë dhe me shumicë të artikujve të ndryshëm në të njëjtin ambient tregëtar i cili është deklaruar si vend për shitje me shumicë dhe pakicë. Në këtë kuptim shoqëria nuk e ka të organizuar aktivitetin tregëtar në ambiente të ndara, për shitje me shumicë nga shitjet me pakicë.

Në përfundim njoftim vlerësimi i nxjerrë nga DRT Korçë është akt administrativ i ligjshëm dhe si i tillë duhet të lihen në fuqi.

Vendim: Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në përfundim të gjykimit vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë nr. ____ datë ____ e cila kishte vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.

16. Vendim nr. ____, datë ____, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës: Shoqëria “M” sh.p.k, me Nipt _____

I Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë
Drejtoria e Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit

Objekti: Sigurimin e padisë duke bërë pezullimin e zbatimit të vendimit për dënimin me gjobë nr. _____, datë ____ të Degës Rajonale Tatimore Vlorë.

Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ, vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. _____ Prot, datë ____ dhe të vendimit nr. ska, datë ska, marrë njoftim nëpërmjet vlerësimit për detyrimet e datës ____ me nr. ____ prot., të Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, përkthësisht neni 119, pika 1, gërma a), neni 122, pika 1, gërma g);
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 80.3 gërma c), 108.5;

3. Ligji nr. 49/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”;
4. Kodi i Procedurave Administrative neni 116.
5. Ligji nr. 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 3.

Përmbledhje e Fakteve:

Subjekti “M” sh.p.k me Nipt ____ i është nënshtruar një kontrolli nga Inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Qarkut Vlorë, bazuar në urdhrin e punës me nr. ____ prot, datë _____. Nga kontrolli i ushtruar referuar akt-konstatimit me nr. serial ____, datë ____ rezulton se subjekti është i regjistruar në QKR, është i pasjitur me kasë fiskale. Në momentin e kontrollit në vendin e punës janë gjetur punonjësit: A T lindur më 22.03.1968 dhe A H lindur më 09.08.1964, gjithashtu nga kontrolli ka rezultuar se subjekti nuk kishte bërë kolaudimin e kasës.

Në bazë të Akt Konstatimit të mbajtur është mbajtur dhe Proces-Verbal Gjobë me nr. serial ____, datë ____ ku në bazë të ligjit 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 119 pika 1, gërma (a), subjekti është penalizuar me gjobë 2 x ____ = ____ (një milion) lekë, për çdo punonjës të pa deklaruar.

Në bazë të Akt Konstatimit të mbajtur është mbajtur procesverbal gjobë me nr. serial ____, datë ____, ku në bazë të ligjit 9920 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 122 pika 1, gërma (g), subjekti është penalizuar me gjobë ____ lekë, për mosmbajtje në gjendje pune të pajisjes fiskale.

Subjekti është penalizuar me gjobë në vlerën ____ lekë, për këto penalitete subjekti është njoftuar me anë të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr. ____ prot, datë ____.

Me vendimin nr. ____, datë ____ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, ka vendosur:

- 1- Pranimin e kërkesë padisë si të pa bazuar në fakte, prova e në ligj.
- 2- Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë.

Gjykata arsyeton se, pala e paditur DRT Vlorë e ka vendosur këtë gjobë në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore.

Janë shkelur kërkesat e nenit 84 të ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 3. *Inspektorët kanë shkelur kërkesat e ligjit nr. 9920/2008, përsa i përket njoftimit të kontrollit tatimor, pasi nuk kanë pasur ndonjë urdhër të posacëm apo të përgjithshëm në lidhje me kontrollin e subjektit të palës paditëse.*

Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptim të nenit 325 të KPrC. Gjithashtu, gjykata arsyeton se jemi përpara aktit absolutisht të pavlefshëm pasi prej palës së paditur nuk është respektuar procedura.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit, ai duhet të ndryshohet duke u vendosur rrëzimi i padisë. Akti i konstatimit rezulton

të jetë nënshkruar nga grupi i kontrollit i përbërë nga tre inspektorët si dhe rezulton i nënshkruar pa vërejtje nga subjekti. Gjendja e konstatuar është pasqyruar korrektësisht në aktin e konstatimit nga ana e inspektorëve tatimor të verifikimit në terren të palës së paditur.

Veprimtaria e kontrollit rezulton në përputhje me përcaktimet e nenit 80 të ligjit nr. 9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar dhe pikën 80.3, gërma c) i cili detajon verifikimin në vend si formë e kontrollit tatimor.

Gjykata çmon se, nxjerrja e aktit administrativ për dënim me gjobë respekton kërkesat e nenit 13 të ligjit nr. 10279/2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe se asnjë parregullësi procedurale e kryer nga pala e paditur nuk konstatohet në rastin konkret për ta bërë aktin administrativ absolutisht të pavlefshëm. Zhvillimi i gjykimit në shkallë të parë ka vërtetuar se shoqëria paditëse ka kryer kundërvajtje administrative pasi nuk kishte deklaruar në afatin ligjor, 24 orë para punësimit dy punonjës si dhe nuk kishte në kushte pune kasën fiskale, fakte këto që përmbushin situatat e parashikuara nga nenet 119 dhe 122 të ligjit nr. 9920/2008 “Pë procedurat Tatimore” në Republikën e Shqipërisë.

Vendim:

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. ____, datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kundër vendimit, nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

17. Vendim Nr. ____, datë ____

Paditës: Shoqëria “H M” person fizik, me Nipt _____

I Paditur: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë
Drejtoria e Apelit Tatimor

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit

Objekti:

1. Shfuqizim akti administrativ njoftim vlerësimi nr. ____ prot, datë ____ dhe vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. ____ prot, datë ____.
2. Marrjen e masës së pezullimit të aktit deri në gjykimin e çështjes.

Shuma e detyrimit tatimor: ____ lekë

Baza Ligjore:

1. Ligji 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar përaktësisht Neni 106, 107 pika 1,2,3,4.
2. UMF nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" i ndryshuar, pika 106.2.4, 106.2.6 dhe 107.1, 107.2.1, 107.3.1.
3. Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" neni 16, 39 pika2,;
4. Kodi i Procedurave Administrative neni 129.

Përmbledhje e Fakteve:

Subjekti "H M" person fizik, me Nipt _____ i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke parashtruar kundërshtimet e tij në lidhje me me raportin e kontrollit të mbajtur nga DRT Vlorë me nr. ____ prot, datë ____ mbi bazën e të cilit ka dalë njoftim vlerësimi nr. ____ prot, datë ____ me vlerën ____ lekë.

Nga Inspektorët e DRT Vlorë në datën 06.06.2017 deri në datën 10.06.2017 është ushtruar kontroll për subjektin "H M" person fizik, me Nipt _____, në zbatim të kontrollit dalë prej DRT Vlorë me nr. ____ prot, datë 02.05.2017, me objekt kontrolli i TVSH-së, Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore, Tatim Fitim etj.

Për kontrollin e kryer në subjekt nga ana e DRT Vlorë është mbajtur Raporti i Kontrollit i datës ____ mbi bazën e të cilit ka dalë si konkluzion se subjektit i linden detyrime në lidhje me TVSH, Tatim Fitimin dhe penalitete të tjera në vlerën totale prej ____ lekë.

Për këtë penalitet paditësi është njoftuar nëpërmjet aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr. ____ prot, datë ____.

Pala paditëse duke mos qenë dakort me detyrimin e nxjerrë prej DRT Vlorë i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor.

DAT me vendimin nr. ____ prot, datë ____ ka vendosur:

1-Refuzimin e ankimit ndaj Njoftim vlerësimi nr. ____ prot, datë ____ të DRT Vlorë për shkak se nuk është plotësuar kushti ligjor për pagesën apo vendosjen e garancisë bankare për detyrimin e plotë tatimor të përcaktuar në aktin administrativ të ankimuar.

Në bazë të kërkesës së DRT Vlorë për mospranimin e padisë së paditësit pasi nuk është ezauruar rruga administrative, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin nr. ____, datë ____ ka vendosur:

Mospranimin për shqyrtim të kërkesë-padisë me paditës Person Fizik "H M" me të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë me objekt:

Shfuqizim të Aktit Administrativ Njoftim Vlerësimi nr. ____ Prot, datë ____ dhe Vendimit të Drejtorisë së Apelit Tatimor nr. ____ prot datë ____.

Marrjen e masës së pezullimit të aktit administrativ deri në gjykimin e çështjes e cila i përket çështjes administrative me nr. ____ Akti, datë regjistrimi _____.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit çmon se vendimi nr. ____ datë ____ i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është marrë në interpretim të saktë të ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Gjykata vlerëson se ligji nr.9920, date 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar parashikon rrugën administrative të ankimit të një akti, dhe kundërshtimi

i tij në gjykatë përbën lëndë gjykimi për juridiksionin gjyqësor, vetëm pasi të jetë ezauruar ankimi dhe të ketë një vendimmarrje nga ana e Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Në lidhje me nocionin e shterimit të ankimit administrativ, së fundmi ka mbajtur qëndrim dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. _____, datë _____, në të cilin arsyetohet se: *"Neni 9 i ligjit nr. 49/2012 parashikon se '1. Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent'".*

Në interpretim të dispozitës së sipërcituar gjykatat në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor kanë detyrimin ligjor të bëjnë vlerësimin e çështjes nëse ajo i përket juridiksioni gjyqësor ose jo, verifikimi ky i cili bëhet kryesisht ose me kërkesë të palëve.

Ky detyrim lidhet ngushtësisht me respektimin e nenit 16 të ligji nr. 49/2012 për "shterimin e ankimit administrativ", pasi lidhet me të drejtën e paditesit për t'iu drejtuar ose jo rrugës gjyqësore për të mbrojtur të drejta e tij.

Kjo dispozitë parashikon se: *"1. Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ. 2. Përrjashtohen nga ky rregull rastet kur: ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar; ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë; organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cënuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personalë të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ'".*

Sa më lart, u provua, në rastin konkret nuk është shteruar rruga e ankimit administrativ si një ndër kushtet kryesore për ngritjen e padisë dhe juridiksionin e gjykatës administrative, për shqyrtimin e çështjes. Në referim të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe nenit 39 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë më të drejtë ka vlerësuar se ndodhemi para mospranimit të padisë, pasi padia nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj.

Mospërmbushja e kërkesave të ligjit nga pala paditëse mbi mos shterimin e ankimit administrativ, përbën shkak që gjykata ta konsiderojë se mungon juridiksioni gjyqësor.

Në këto kushte, Gjykata Administrative e Apelit, ashtu si dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, çmon se kërkesëpadia e paraqitur nga pala paditëse nuk plotëson kushtet formale për paraqitjen e padisë, pasi pala paditëse nuk ka shteruar ankimin administrativ, sikundër u parashtrua me sipër.

Vendim: Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. ____, datë _____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Kundër vendimit, lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë.

18. Vendim nr. ___ datë ___, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë

Paditës : Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Shkodër

I paditur : Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

Objekti : Kundërshtimin e aktit administrativ nr. ___ datë ___ të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër për periudhën Dhjetor 2014 – Janar 2015”

Shuma e detyrimit tatimor : _____ lekë

Baza ligjore : Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 113 “Mosdeklarim në afat” i tatimit në burim.

Përmbledhje e rrethanave të faktit :

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar subjektin me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimeve ___ datë ___ (gjobë periudha tatimore 2014/12) dhe Njoftim Vlerësimi ___ datë ___ (gjobë periudha tatimore 2015/01), gjoba këto për *mosdeklarim në afat të tatimit në burim*.

Subjektit i kanë rezultuar sanksione për deklarim të vonuar të detyrimit në fjalë, vlerësuar nga sistemi informatik tatimor, pasi subjekti ka bërë deklarimin e këtij detyrimi, ndonëse me vlerë (o) vetëm me datë ___, për periudhat tatimore dhjetor/2014; janar/2015, pra jashtë afatit ligjor.

Në nenin 113 i ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “**Mosdeklarimi në afat**” parashikohet se:

Tatimpaguesi, i cili nuk dorëzon deklaratën tatimore në afat, dënohet me gjobë me 10 000 lekë për çdo deklaratë tatimore të padorëzuar.

- Subjekti duke mos qenë dakort me këto vlerësime të organit tatimor i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me një kërkesë ankimore.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj, komunikuar subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me shkresën nr. ___ prot datë ___ nëpërmjet të cilit vendosi:

- Shfuqizimin e aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi datë 22.03.2015, njoftuar nga DRT Shkodër, për gjobën për mosdeklarim në afat të tatimit në burim për periudhën shkurt 2015.
- Refuzimin e ankimit, me objekt aktet administrative, njoftim vlerësimet për detyrimet tatimore datë ___ të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për gjobat për mosdeklarim në afat të tatimit në burim, për periudhën dhjetor 2014- janar 2015, pasi ka kaluar afati i ankimit tatimor.

Nga subjekti nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij ankimore, kërkesa këto të përcaktuara në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 106/3 dhe Udhëzimit në zbatim të tij.

Në nenin 106 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH-së” i ndryshuar, “*Objekti i ankimit administrativ tatimor*” parashikohet se:

- *Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor në lidhje me tatimpaguesin.*

- Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji me udhëzim të Ministrit të Financave.

- *Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në Drejtorinë e Apelimit Tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.*

Në Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008, i ndryshuar për zbatimin e këtij ligji, pika 106.3.1 shprehet:

Ankimi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur akti administrativ është marrë ose konsiderohet të jetë marrë; afati shtyhet në ditën pasardhëse të punës në qoftë se dita e fundit e afatit bie në ditë pushimi apo feste zyrtare....

Në paragrafin 23.3.6 dhe në vijim të këtij Udhëzimi shprehet se:

Konsiderohet si moment i dërgimit të dokumentit elektronik, koha kur dokumenti elektronik del nga sistemi kompjuterik i dërguesit.

Konsiderohet si moment i marrjes së dokumentit elektronik, koha kur dokumenti elektronik hyn në sistemin kompjuterik të marrësit dhe/ose në sistemin kompjuterik të personit të autorizuar prej tij, që është ose jo nën kontrollin e marrësit apo nën kontrollin e një personi të autorizuar prej tij dhe që është dërguar në llogarinë e tatimpaguesit apo në postën elektronike të tij (e-mail).

Konfirmimi i marrjes së dokumentit në rrugë elektronike nga ana e administratës tatimore dhe tatimpaguesit do të konsiderohet momenti, kur pasi dokumenti është dërguar në sistemin elektronik tatimor të shërbimit apo pasi veprimi është dërguar në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në këtë shërbim apo të postës elektronike të tij, ai është konfirmuar si i marrë nëpërmjet konfirmimit automatik të marrjes nga sistemi kompjuterik, por në çdo rast si afat i vlefshëm për të konsideruar si të marrë dokumentin do të jetë dita e 10-të nga data e dërgimit të dokumentit....

Në interpretim të këtyre dispozitave afati maksimal i marrjes dijeni nga tatimpaguesi për aktet administrative, vlerësohet nga administrata tatimore 10 ditë pas marrjes së konfirmimit automatik të marrjes nga sistemi kompjuterik.

Referuar vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor aktet mbajnë datën 17.03.2015, ndërsa ankimi është hedhur në shërbimin postar me datë 29.04.2015 dhe është dorëzuar në D.P.T-ve datë 30.04.2015, pra jashtë afatit ligjor.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore.

Në nenin 16 të ligjit nr.49/2012 datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” pika 1 parashikohet se:

1.Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ.

Sa më lart tatimpaguesi nuk ka përmbushur kërkesën ligjore (neni 106/3) lidhur me respektimin e afatit të paraqitjes së ankimit administrativ, Drejtoria e Apelimit Tatimor duke refuzuar kërkesën e subjektit nuk ka shqyrtuar në thelb çështjen.

Pra pala paditëse nuk kishte ezauruar rrugën administrative të shqyrtimit të çështjes, mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor.

➤ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në lidhje me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.____ datë ____ sipas të cilit vendosi :

- *Mospranimin e kërkesë-padisë*

➤ Mbi bazën e kërkesës ankimore të palës paditëse çështja u shqyrtua nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila me vendimin e saj nr.____ datë ____ ka vendosur :

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.*

Arsyetimi ligjor i gjykatës :

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.____ datë ____, nëpërmjet të cilit vendosi :
 - *Mospranimin e kërkesë-padisë*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, pasi gjykoi çështjen me vendimin e saj ka arsyetuar se:

Kërkimi i palës së interesuar në lidhje me atë se çfarë po kërkohet konkretisht para gjykatës nuk lidhet me fjalët që përdoren në objektin e padisë e me nenet që vendosen si bazë ligjore, por lidhet me të gjithë parashtrimin që bëhet në padi e në seancë duke konsideruar nenin 5, nenet 153 e vijues të K.Pr.Civile dhe në këtë drejtim kërkimi i palës paditëse është i paqartë e kontradiktor.

Gjykata konsideron, se kërkesë-padisë së paraqitur në gjykatë i mungojnë kushtet formale të paraqitjes së saj (nenet 16 - 19 të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative").

Në gjykatë mund të drejtohesh kur ke marrë apo nuk ke marrë një përgjigje nga organi publik, për atë çfarë mund t'i jesh drejtuar atij dhe kur veprimet e kryera nga organi publik kanë sjellë pasojë juridike duke cënuar të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm.

Jemi para një padie pa objekt gjykimi, ku e drejta e pretenduar e cënuar nuk mund të realizohet nëpërmjet kësaj padie dhe në këtë drejtim pala paditëse nuk është në të drejtën e saj për të realizuar të drejtën e pretenduar nëpërmjet padisë, pasi nuk ka ngritur padinë e duhur për gjykim.

Për të realizuar të drejtën e pretenduar nëpërmjet padisë, për të kundërshtuar veprimin administrative duhet shteruar ankimi administrativ.

Pala paditëse është vënë në dijeni të veprimeve administrative me aktin administrativ, njoftim vlerësimin për detyrimet tatimore nr.____prot datë __ (për periudhën dhjetor 2014 dhe janar 2015) të palës së paditur DRT Shkodër dhe nuk ka shteruar ankimin (rekursin) administrativ.

Citimi i provave pa i paraqitur ato dhe paraqitja e provave jo konform kërkesave të ligjit e vendos gjykatën në pamundësi të zhvillimit të gjykimit (palët janë në të drejtën e tyre për të paraqitur prova deri përpara seancës së parë gjyqësore dhe mosparaqitja e provave përpara seancës së parë gjyqësore shkakton mospranimin e tyre).

Gjykimi duhet ndalur këtu pa u shprehur për themelin e kërkimit për veprimet e kryera nga pala e paditur.

Në këto kushte gjykata çmoi, se duhet të vendosë mospranimin e kërkesë-padisë, pasi ajo nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj.

- Mbi bazën e ankimit të palës paditëse çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila doli me vendimin e saj nr.____ datë __ sipas të cilit vendosi :
Lënien në fuqi të vendimit nr.____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër; Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmyja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar me shkrim.

Gjykata Administrative e Apelit duke patur parasysh kërkesë-padinë e palës paditëse Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Shkodër, vendimin jopërfundimtar të marrë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër dhe ankimin e paraqitur përkundrejtë këtij vendimi

thekson për palët ndërgjyqëse, se kjo gjykatë si gjykatë e shkallës së dytë vlerëson me prioritet dhe në mënyrë parësore nëse vendimmarrja jopërfundimtare e Gjykatës së Shkallës së Parë është një vendimmarrje e cila vjen si rezultat i kryerjes së një procesi të rregullt ligjor.

Procesi i rregullt ligjor/ gjyqësor administrativ është i normuar nga ligji 49/2012 dhe K.Pr.Civile. Të dy këto akte procedurale ligjore normojnë dhe kornizojnë veprimet procedurale ligjore në të cilat duhet të kalojë procesi gjyqësor administrativ në shkallë të parë kusht për marrjen e një vendimi gjyqësor në përputhje me ligjin.

Duke patur parasysh llojin e vendimmarrjes së marrë nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata Administrative e Apelit verifikoi kushtet formale të padisë së paraqitur për gjykim, pasi vetëm në këtë mënyrë Gjykata Administrative e Apelit konkludon nëse në rastin objekt gjykimi vendimmarrja nga Gjykata e Shkallës së Parë është një vendimmarrje e marrë në bazë dhe për zbatim të ligjit.

Nga vet përmbajtja e padisë së paraqitur nga pala paditëse në Gjykatën e Shkallës së Parë Shkodër rezulton, se kjo padi personifikon një mosmarrveshje administrative të lindur ndërmjet palës paditëse Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Shkodër dhe palës së paditur D.R.T-ve Shkodër. Duke u bazuar në përmbajtjen e padisë dhe në thelbin e pretendimeve të palës paditëse të parashtruara në të, në respektim edhe të vendimit unfikues nr.3 Viti 2012 të Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit konkludon, se objekti i mosmarrëveshjes të kësaj çështje janë pretendimet në themel të padisë së palës paditëse për paligjshmërinë e njoftim vlerësimit për detyrimin tatimor datë _____, akt ky i marrë nga D.R.T-ve Shkodër.

Sa më lart është edhe objekti i padisë dhe objekti i mosmarrëveshjes, pasi në nenin 31 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se:

"Padia është e drejta e personit që bën pretendimin për t'u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë, që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo. Pala kundërshtarë ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligj të këtij pretendimi". Gjithashtu në nenin 17 të Ligjit nr.49 të vitit 2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" parashikohet se :

"Padia ngrihet:

a) për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ".

Përkatësisht në lidhje me këtë moment dhe me këtë natyrë lloj padie gjykata mban parasysh, se akti që kundërshtohet me këtë padi për paligjshmëri është një akt i rnarë në bazë të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. E drejta e vendosur në themel të kësaj padie është e drejta që bazohet në legjislacionin tatimor. Në lidhje me këtë moment Gjykata Administrative e Apelit mban parasysh, se në piken 106.1.1 të Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar është parashikuar se : "Sipas nenit 106 të ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", tatimpaguesi mund të ankimojë kundër:

a) Çdo akti administrativ të administratës tatimore,

b) i cili ka të bëjë me tatimpaguesin dhe

c) ndikon në detyrimin e tij tatimor.

Këto tre kërkesa duhet të plotësohen detyrimisht të gjitha. Gjithashtu në pikën 106.1.2 të këtij Udhëzimi jepen disa shembuj të vendimeve administrative, që mund të ankimohen lidhur me tatimpaguesin dhe detyrimin e tij tatimor. Një nga shembujt e përcaktuar në këtë pikë germa (a) është

çdo njoftim-vlerësimi detyrimi tatimor. Pra, nga vet përmbajtja e këtyre dy parashikimeve ligjore rezultojnë se, njoftim vlerësimet tatimore për detyrimet tatimore të tatimpagueseve përfshihen në ato akte administrative, që mund të ankimohen nga subjekti tatimor që ato i kundërdrejtohen.

Në rastin konkret nuk rezultojnë, që pala paditëse të ketë kryer rekurs administrativ përkundërtë këtij akti. Pala paditëse jo vetëm që nuk ka ushtruar rekursin administrativ përkundërtë këtij akti, por për më tepër ka paraqitur këtë padi në gjykatë në një afat kohor me shumë se 5 muaj nga koha e nxjerrjes së vet aktit administrativ.

Sa më lart Gjykata Administrative e Apelit konkludon se, në rastin konkret kjo padi në respektim të natyrës së saj, llojit të saj, kërkimit të saj rezultojnë të jetë paraqitur për gjykim në kundërshtim me rregullat proceduriale gjyqësore administrative pa respektuar kushtet formale që ligji kërkon për paraqitjen e saj.

Si rrjedhojë me të drejtë Gjykata e Shkallës e Parë nuk ka lejuar shqyrtimin gjyqësor të kësaj padie. Gjykata në përfundim të kësaj analize ligjore të fakteve objekt verifikimi duke vlerësuar kërkimet e palës paditëse në padi dhe në ankim, prapësimet e palës së paditur, raportin shkak ligjor-bazë juridike objekt kërkimesh gjendje fakti, pasi çmoi provat e marra në gjykim konkludon, se vendimi me nr.____i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër është marrë në zbatim të ligjit dhe duhet të lihet në fuqi me këtë vendim.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi i dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër duhet të lihet në fuqi.

Vendimi i Gjykatës :

Gjykata Administrative me vendimin nr.____ datë 15.05.2024 vendosi :

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.____ datë ____ të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër;*
- *Kundër vendimit lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar me shkrim.*